



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

MARTESA DHE MARRËDHËNIET INTIME NË ISLAM

Dr. Shefik Kurdiq

Botuar nga: SHB SIRA

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

NË VEND TË PARATHËNIES	7
HYRJE.....	8
KULTURA E SJELLJES NË MARTESË.....	11
ZGJEDHJA E BASHKËSHORT -ES -IT	14
SHIKIMI PARA MARTESËS.....	15
FEJESA	16
NDALOHEK FEJESA E ASAJ QË VEÇMË ËSHTË E FEJUAR	18
AKTI I KURORËZIMIT.....	18
MEHRI- DHURATA E MARTESËS.....	20
SHPALLJA E MARTESËS.....	21
CEREMONIA E DASMËS.....	22
DUHET T'I PËRGJIGJEMI FTESËS PËR DASMË	23
ÇKA DUHET THËNË ÇIFTIT TË POSAMARTUAR?.....	24
FALJA E DY REKATEVE NAMAZ PARA MARRËDHËNIEVE INTIME.....	26
SHPREHJA E DASHURISË NDAJ GRUAS.....	27
TË VENDOSËT DORA NË KOKËN E GRUAS DHE TË BËHET DUA	27
ÇKA DUHET THËNË ME RASTIN E AFRIMIT TE GRUAJA?	28
DUHET PATUR KUJDES TË MOS KTHEHEN KAH KIBLA.....	29
PARA MARRËDHËNIEVE INTIME JEMI TË OBLIGUAR TË PËRGATITEMI	29
CILA POZITË ËSHTË E LEJUAR GJATË MARRËDHËNIEVE INTIME?.....	31

NDALIMI I MARRËDHËNIEVE NË ANUS (VRIMËN ANALE).....	32
LARJA PAS MARRËDHËNIEVE INTIME.....	32
SI TË MARRIM GUSUL?	34
A DUHET TË MIRRET GUSËL PAS ÇDO MARRËDHËNIE INTIME?	34
KUSH KA MË SHUMË SE NJË GRUA, A DUHET TË LAHET PAS AFRIMIT TË SECILËS GRUA?.....	36
A ËSHTË E LEJUAR RUAJTJA NGA SHTATZANIA?	37
ËSHTË E NDALUAR T’I RRËFESH DIKUJT PËR MARRËDHËNIET INTIME	38
KULTURA E SJELLJES SË BURRIT NDAJ GRUAS	38
SJELLJA E MIRË NDAJ GRUAS	39
TË KUPTOSH NEVOJAT DHE ASPIRATAT E SAJ.....	40
T’I NDIHMOJË GRUAS NË PUNË.....	41
TË SIGUROJË FURNIZIMIN	42
BËHU I DREJTË NDAJ GRAVE	44
TE BEQARSHA TË QËNDROJË SHTATË DITË, NDËRSA TE E MARTUARA TRE DITË	45
DASHURIA MË E MADHE NDAJ DISA GRAVE.....	46
XHELOZIA.....	47
BURRI KA OBLIGIME NDAJ GRUAS	48
NËSE GRUAJA E HUAJ JU FASCINON, KOMPENSONE KËTË NË GRUAN TUAJ	49
KULTURA E SJELLJES SË GRUAS NDAJ BURRIT	50
NËNSHTRIM	50

FALËNDERIM.....	51
KUJDESET PËR SHTËPINË DHE FËMIJËT.....	52
RUAN MORALIN E SAJ DHE PASURINË E BURRIT KUR AI MUNGON	54
NUK DO TË AGJËROJË PA LEJEN E BURRIT.....	55
NUK E LËSHON ASKEND NË SHTËPI PA LEJEN E BURRIT	56
NUK E SHQETËSON BURRIN	59
NUK E REFUZON.....	59
NUK E REFUZON, QOFTË DUKE E LËNË EDHE BUKËN TË DIGJET.....	60
KUSHTI PËR XHENNET ËSHTË KËNAQJA E BURRIT.....	61
NUK KA DËGJUESHMËRI NDAJ BURRIT NË MËKAT	61
MARTESA SI MBURROJË NDAJ ANARKISË MORALE	62
EPIDEMIA E AMORALITETIT KA PËRFSHIRË EDHE QENIEN TONË	64
KUSH ËSHTË FAJTOR?!.....	65
ZGJIDHJA ISLAME E KËTIJ PROBLEMI	66
POLIGAMIA MARTESA ME SHUMË GRA	67
QËNDRIMI I DISA MENDIMTARËVE PERËNDIMORË LIDHUR ME POLIGAMINË	71
PËRFUNDIMI	73
KULTURA E SJELLJES ME RASTIN E SHKURORËZIMIT	74
NËSE JANË ME BARRË, MBESIN TE BURRI DERISA TË LINDIN	75
NËSE I JAPIN GJI FËMIJËS, MERITOJNË SHPËRBLIMIN.....	76

DËSHMIMI ME RASTIN E SHKURORËZIMIT OSE KTHIMIT	77
GRAVE NUK DUHET NDALUAR KTHIMIN E SËRISHËM PËR BURRAT E TYRE	78
SA SHKURORËZIME LEJOHEN ME PERSONIN E NJËJTË?	79
ÇKA NËSE VJEN DERI TE SHKURORËZIMI I TRETË?	79
BURRI NUK DUHET TË KËRKOJË T'1I KTHEHET DHURATA E KURORËS	81
GRUAJA DO TË KTHEJË DHURATËN E KURORËS NËSE AJO KA KËRKUAR SHKURORËZIMIN	82
LËSHIMI I GRUAS PARA SE TË KEMI MARRËDHËNIE INTIME ME TË	83
BASHKËSHORTËT LE TË NDAHEN NËSE AKUZOHEN DHE BETOHEN NDËRMJET VETI	83
NËSE BURRI LARGOHET NGA GRUAJA MË SHUMË SE KATËR MUAJ, ËSHTË I OBLIGUAR QË TË NDAHET PREJ SAJ	84
NËSE ZHDUKET BURRI, A MUND TË VIJË DERI TE SHKURORËZIMI	86
NË FUND	87

NË VEND TË PARATHËNIES

Martesa është një institucion shumë i rëndësishëm, të cilit Islami i kushton rëndësi të veçantë. Këtë në mënyrën më të mirë na e ka treguar autori i këtij libri, që është para nesh, e që e trajton martesën dhe marrëdhëniet martesore. Autori me argumente ka sjellur të gjitha gjërat relevante që kanë të bëjnë me këtë temë, duke i bazuar të gjitha qendrimet në bazat kur'anore dhe sunnetin e Resulullahut a.s., e ndonjëherë edhe në mendimet e dijetarëve të hershëm duke paraqitur edhe qëndrimet e tija, që këtë libër na e bëjnë edhe më të dashur.

Në pjesën e parë të librit doc. dr. Shefik Kurdiç, ekspert në lëminë e hadithit, shfrytëzon mjaftë lëminë e tij dhe në themelet e shumë haditheve, nxjerr elementet më të rëndësishme për rëndësinë e martesës dhe marrëdhënieve martesore e pastaj nxjerr konkluzione se martesa është mbrojtja më e mirë nga anarkia morale dhe sëmundjet e rrëzikshme, të cilat e kanë sulmuar botën.

Në pjesën e dytë të këtij libri të vogël, por jashtëzakonisht të dobishëm, trajtohet shkurorezimi dhe krejt çka ka lidhje me këtë segment, duke sjellur tërë argumentet e duhura për gjetjen e modusit si ta ruajmë martesën nga shkurorezimi i padëshiruar që me vete tërhiqet një numër të madh të pasojave të padëshiruara.

Duke vlerësuar këtë libër nga aspekti shkencor i tij, lirisht mund konkludojmë se paraqet një nga projektet më serioze të bërë në gjuhën tonë në këtë fushë, dhe me të drejtë mund presim që të bëhet një burim relevant në fushën e të drejtës familjare islame, dhe si e tillë do të jetë e mirëseardhur për studentët e të drejtës së sheriatit, në përgjithësi dhe të drejtës familjare në veçanti.

Ngrohësisht e rekomandojmë këtë libër për nxënësit e medreseve, studentëve dhe të gjithë lexuesëve që deshirojnë t'i zgjerojnë njohuritë e tyre.

Doc. Dr. Shukri Ramiq

Dr. Izet Terziq

HYRJE

Islami është fe natyrore që përfshinë të gjitha segmentet dhe detajet e jetës njerëzore, aq përfshirës, i lidhur dhe i gërshetuar, sa që mbulon të gjitha nevojat e përhershme njerëzore. Allahu xh.sh. ka dashur që Islami të jetë sistem për tërë jetën e njeriut në të gjitha aspektet e tij. Nuk e ka bërë atë vetëm besim të pastër emocional, të shkëputur nga fushëveprimtaria reale e ekzistencës së njeriut, por e ka bërë që thellë të depërtojë në të gjitha sferat shoqërore, sociale, morale, politike, ushtarake, juridike etj. Islami ka rregulluar gjithçka, që është me rëndësi, dhe asgjë nuk ka lënë të paqartë dhe të mangët.

Islami është shpallur me qëllim që të rregullojë jetën në formën e saj praktike dhe realitetin konkret t'ia nënshtrojë kriterëve të tij. Ai, në bazë të natyrës së tij, nuk duron të jetë i paraqitur vetëm si kategori shpirtërore dhe kulturore, sepse kjo bie ndesh me natyrën e tij dhe me qëllimin e tij final. Ai asnjëherë nuk zhvillohet në teori të pastër, por gjithmonë mbanë statusin e realitetit dinamik. Madje mjafton vetëm një analizë sipërfaqësore për të ardhur në përfundim se islami ka specifikat e tij, të cilat plotësisht e distancojnë atë nga ideologjitë, sistemet dhe religjionet tjera.

Brenga për njeriun vërehet në islam edhe para lindjes së tij, që është specifike e veçantë e kësaj feje. Pas lindjes kjo brengë bëhet edhe më e madhe dhe më e fortë. Islami ka rregulluar të gjitha detajet jetësore, me qëllim që njeriu të mos humbet në labirinthin e jetës dhe të botës, dhe të mos ndjehet si i lënë pasdore. Njeriu, duke shfletuar literaturën islame, do të përfundojë se gjithherë është nën mbikqyrje dhe ka Dikush që e mbikqyrë, ushqen dhe mbronë.

Nëse analizojmë vetëm martesën dhe marrëdhëniet martesore, do të zbulojmë se sa vëmendje i kushton Islami këtij segmenti të jetës së njeriut. Sa ajete e hadithe trajtojnë këtë pjesë të jetës? Sa detaje ilustrjnë nevojën e bashkëshortëve që të jenë së bashku?! Krahasimi kur'anor: *ato janë veshja juaj dhe ju jeni veshja e tyre* në mënyrën më eklatante flet për patjetërsueshmërinë e jetës së përbashkët dhe ndërtimit të bashkësisë martesore.

Pohimi i të Dërguarit të Islamit, Muhamedit s.a.v.s, se *me hyrjen në bashkësinë martesore plotësojmë gjysmën e imanit*, në mënyrë shumë serioze flet për nevojën e këtij institucioni, pa të cilën nuk ka as moral, as vazhdim të llojit njerëzor, as krenari në Ditën e Gjykimit!

Në këtë libër jam përpjekur, në bazë të burimeve relevante të sheriatit, në mënyrë të argumentuar të paraqes atë çka është me rëndësi për martesën dhe marrëdhëniet martesore në islam, duke

shqyrtuar edhe shkurorezimin, si pasojë jo e dëshiruar, e atyre këshillave që nuk respektohen gjatë vetë martesës.

Dëshira ime kryesore është që nëpërmjet martesës si preventivë nga amoraliteti, të tregoj edhe një hapësirë të gjërë, jo vetëm shpirtërore, por edhe të kënaqësive trupore të cilat Islami ia ka dhënë burrit dhe gruas dhe fleksibilitetin e jashtëzakonshëm të islamit në këtë drejtim. Mënyra e vetme që të largohet anarkia morale dhe amoraliteti, të cilat për fat të keq te ne, tani janë në shkallën më të lartë që nga ardhja e fesë Islame në këto troje, është vendosja e martesës normale dhe të ligjshme.

Në fund të librit kam trajtuar edhe shkurorezimin, si nevojë me rastin e pamundësisë së vazhdimit të bashkësisë martesore dhe kam treguar në parregullsitë të cilat i bëjnë disa muslimanë me këtë rast.

Shpresoj se me ndihmën e Allahut xh.sh., kjo libër të japë kontribut në forcimin e bashkësisë martesore, do të kontribuojë, sadopak, në numrin më të vogël të shkurorezimeve dhe do të jetë udhërrëfyes i të rinjëve në marrëdhëniet e tyre martesore dhe intime (seksuale).

Zenicë 7.7.2003

doc.dr. Shefik Kurdiç

KULTURA E SJELLJES NË MARTESË

Martesa është themeli i familjes. Pa martesë nuk ka familje ndërsa pa familje nuk ka as bashkësi njerëzore. Vetëm me martesë sigurohet zhvillimi normal i bashkësisë njerëzore. Për këtë, Allahu xh.sh., institucionin e martesës e ka bërë të obliguar, me qëllim që lloji njerëzor të vazhdojë normalisht rrugëtimin e tij.

Allahu i Madhërishëm e krijoi llojin njerëzor prej burrit dhe gruas, dhe e bëri që njëri pa tjetrin nuk mund të jetojnë, duke ia bërë me dije Muhamedit s.a.v.s: *“Ne dërguam edhe para teje të dërguar dhe atyre u mundësua të kenë gra e fëmijë.”*¹ Duke i krijuar njërin prej tjetrit dhe duke e ditur se nuk mundën njëri pa tjetrin, Ai urdhëron martesën si mënyrë e vetme natyrore e bashkimit të tyre: *“... atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë...”*² Në një ajet tjetër Ai nxitë: *“Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit)...”*³

I Dërguari i All-llahut gjithashtu në shumë hadithe të tij na ka nxitur në bashkimin e personave të gjinisë së kundërt për lidhje martesore. Madje na tërheq vërejtjen se mos praktikimi i martesës është një lloj i mos praktikimit të sunnetit dhe largim nga ai, nga drejtimi i tij. Në hadithin të cilin e transmeton gruaja e tij e ndershme Aisha r.a., në mënyrë të thuktë thuhet: *“Martesa është nga*

¹ *Kur’ani:* Rra’d, 38

² *Kur’ani:* Nisa’ë, 3

³ *Kur’ani:* Nurë, 32

*sunneti im. Kush nuk e praktikon sunnetin tim, nuk më takon mua! Martobuni, sepse unë do të krenohem me numrin e ummetit tim ndaj të tjerëve! Kush ka mundësi- le të martobet, e kush nuk mundet- le të agjërojë, sepse agjërimi është mbrojtje!*⁴

Posaçërisht martesë, siç na bën të ditur i Dërguari i All-llahut, s.a.v.s., në mënyrë preventive ndikon në shiqim dhe organet gjenitale. Abdullah ibn Mesudi r.a., përcjell se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “O të rinjë, kush ka mundësi le të martobet, sepse ajo është më mirë për nderin dhe më e ndershme për organin gjenital. E kush nuk ka mundësi, atëherë le të agjërojë, sepse agjërimi është mburojë!”⁵

I Dërguari Muhamed s.a.v.s. duke e ditur rëndësinë e jashtëzakonshme të këtij institucioni, ka ndaluar celibatin /beqarinë e përhershme. Këtë qartë e vërejmë në transmetimin e Sa’d ibn Ebi Vekkasit r.a. ku thuhet: “I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ia ka refuzuar celibatin/ mosmartesën e Othman ibn Madh’unit, i cili këtë e kërkoi nga ai (nga i Dërguari s.a.v.s.)!”⁶

⁴ Ibn Maxhe, *Sunnen*: 9-Kitabu-n-nikah, 1-Babun ma xhae fi fadli-n-nikah, hadithi nr. 1864.

Këtë hadith muhadithët e njohur Muhammed Fuad Abdulbaki dhe Muhammed Nasiruddin Albani e konsiderojnë autentik. (Krahaso: Ibn Maxhe, *Sunnen*,1/592, Botimi: Daru-l-hadith, Kajro, 1994 dhe Albani, *Sabihu-l-Xhami’i-s-sabibi ve zjjadetubu*, 2/1151, hadithi nr. 6807)

⁵ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 3-Babun men lem jesteti’i-l-baete fe-l-jesum, hadithi nr. 5066; Muslimi, *Sabih*: 16-Kitabu-n-nikah, 1-Babu istihbabi-n-nikah, hadithi nr. 1400; Tirmidhiu, *Sunnen*: 9-Kitabu-n-nikah, 1-Babun ma xhae fi fadli-t-tezvixhi ve-l-hassi’alejhi, hadithi nr. 1081 dhe e konsideron si hasen-sahih.

⁶ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 8-Babun ma jukrehu mine-t-tebettuli ve-l-hisai, hadithi nr. 5073; Muslimi, *Sabih*: 16- Kitabu-n-nikah, 1-Babu istihbabi-n-nikah, hadithi nr. 1402; Nesaiu, *Sunnen*: 26-

I Dërguari i Allahut, s.a.v.s. ka paralajmëruar se nëse lihet pasdore martesë, do të paraqitet amoraliteti dhe anarkia në shoqëri, të cilën më së miri mund ta vërejmë në kohën e sotme me ç'rast janë shtuar shumë sëmundje të pashërueshme si pasojë e mosrespektimit të ligjit të Allahut dhe paralajmërimeve të Muhamedit s.a.v.s. Në hadithin të cilin e transmeton Ebu Hatim El-Muzeni r.a., ai tërheq vërejtjen: *‘Kur t’ju vjen dikush në fenë dhe moralin e të cilit jeni të kënaqur-martone! Nëse këtë nuk e bëni, do të paraqitet në tokë anarkia dhe amoraliteti!’*⁷

Martesa nuk ka qenë praktikë vetëm e të Dërguarit të fundit të Allahut, Muhamedit s.a.v.s., por ka qenë sunnet i të gjithë të Dërguarve, salavatullahi’ alejhim exhmeinë, duke veçuar Isanë a.s., për të cilin thuhet se këtë sunnet do ta plotësojë kur të paraqitet në ahiri-zeman (kohën e fundit), me ç'rast do të ketë edhe trashëgues.⁸

Kitabu-n-nikah, 4-Babu-n-nehji ‘ani-t-tebettul dhe Tirmidhiu, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 2- Babun ma xhae fi-n-nehji’ani-t-tebettul, hadithi nr. 1083 dhe e konsideron si hasen-sahih.

⁷ Tirmidhiu, *Sunen*: Kitabu-n-nikah, 3-Babun ma xhae idha xhaekum men terdavne dinehu fezevixhuhu; hadithi nr. 1085 dhe e vlerëson si hasen-garib. Imam Tirmidhiu shënon se transmetues i këtij hadithi është sahabiu Ebu Hatim el-Muzeniu r.a., i cili përveç këtij hadithi nuk ka transmetuar asnjë hadith tjetër, dhe për këtë shkak Tirmidhiu e vlerëson përveç hasen edhe garib.

⁸ Për këtë shih: Gazaliu, *Ihjaw ‘ulum-i-d-din*, 2/97. (Botimi i: Darul-l-Kitabi-l-‘arebi, Bejrut).

Se martesja ka qenë praksë e të gjithë të Dërguarve të mëhershëm, më së miri ilustron fjalët e të Dërguarit të fundit të Allahut, Muhamedit s.a.v.s.. Ebu Ejubi r.a. transmeton se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: *“Katër gjëra janë sunneti të dërguarëve: turpi, aromati, misvaku dhe martesja!”*⁹

ZGJEDHJA E BASHKËSHORT -ES -IT

Zgjedhja e bashkëshort-es –it është me rëndësi sepse zgjedhja e vërtetë mund të jetë lumturi për dikë apo edhe fatkeqësi. I Dërguari i Allahut, Muhamedi s.a.v.s. në hadithin të cilin e transmeton Sa’ud r.a. thotë: *“Katër gjëra e bëjnë njeriun të lumtur: gruaja e mirë, vendbanimi i përshtatshëm, fqiu i mirë dhe mjeti i udhëtimit i rehatshëm, ndërsa fatkeq e bëjnë: gruaja e keqe, shtëpia e vogël, fqiu i keq dhe mjeti jo i përshtatshëm i udhëtimit.”*¹⁰

Shumë faktorë ndikojnë në zgjedhjen e bashkëshortes -it. Ndonjëherë ajo është bukuria, ndonjëherë pasuria, ndonjëherë familja me prestigj e ndonjëherë karakteri, morali dhe besimi. I Dërguari i Allahut, Muhammedi s.a.v.s. na ka udhëzuar që në zgjedhjen tonë të peshojë kjo e fundit (morali dhe besimi), me çka do të plotësohet dhe kompensohet ajo që eventualisht mungon nga faktorët e lartpërmendur. Nëse nuk merret parasysh feja dhe kualitetet morale, të

⁹ Tirmidhiu, *Sunen*: 9 – Kitabu-n-nikah, 1-Babun ma xhae fi fadli-t-tezvixhi ve-l-hassi ‘alejhi, hadithi nr. 1080 dhe e vlerëson si hasen garib.

¹⁰ Hakimi, *El-Mustedrek*; Bejhekiu, *Sbu’abu-l-iman* dhe Ebu Nu’ajm, *Hil ’jetu-l-evlija’*. Albani këtë hadith e vlerëson si të saktë. (Shih: *Sabibu-l-Xhami’i-sagiri ve zjjadetubu*, hadithi nr. 887).

gjithë faktorët tjerë për të cilët mund të hyjmë në martesë ka mundësi që shumë shpejtë të shndërrohen në të kundërtat e tyre. Në hadithin që e transmeton Ebu Hurejre r.a., i Dërguari s.a.v.s. na udhëzon: *“Gruaja merret për katër gjëra: për shkak të pasurisë, prejardhjes, bukurisë ose fesë. Merreni atë me fe, do të jeni të bekuar.”*¹¹

SHIKIMI PARA MARTESËS

Për të qenë martesë afatgjate, duhet që para martesës të njohim bashkëshorten -in, kjo do të thotë, t'i njohësh kualitetet ose eventualisht mangësitë e saj (tij). I Dërguari s.a.v.s. ka rekomanduar shikimin e personit me të cilin dëshirojmë të martohemi, kështu që gjatë martesës, të mos vijë deri te pasojat e padëshirueshme. Në hadithin që e transmeton Ebu Hurejre r.a., thuhet: *“Isba te i Dërguari s.a.v.s., kur i erdhi një njeri dhe e njoftoi se e ka fejuar një ensare. I Dërguari i Allabut, s.a.v.s. e pyeti: A e ke parë atë? Ai është përgjigjur: Jo. I Dërguari s.a.v.s. i tha: Shko e shikoje atë,*

¹¹ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 15-Babu-l-ekfai fi-d-dini, hadithi nr. 5090 dhe Muslimi, *Sabih*: 17-Kitabu-r-reda', 15-Babu istihbabi nikahi dhati-d-dini, hadithi nr. 1466.

*sepse me të vërtetë në sytë e ensarëve ka diçka!*¹² Disa e komentojnë këtë hadith se në sytë e tyre mund të ketë ndonjë mangësi, si p.sh. të pamurit e dobët etj.¹³

El Mugire ibn Shu'be r.a., transmeton se e ka njoftuar Muhamedin s.a.v.s. se e ka fejuar një vajzë, me ç'rast Muhamedi s.a.v.s. e ka këshilluar: *“Shko dhe shikoje, sepse kejo, me të vërtetë është më e sigurtë për jetëgjatësinë e lidhjes suaj!”*¹⁴

FEJESA

Mënyra më e mirë për të treguar seriozitetin e ndonjë lidhje është fejesa. Në këtë rast i riu duhet të shohë vajzën, mirëpo gjithçka duhet të jetë në kufijtë e rregullave islame. Ka mendime të

¹² Muslimi, *Sahih*: 16-Kitabu-n-nikah, 12-Babu nedbi-n-nedhari ila vexhhi-l-mer'eti ve keffejha limen juridu tezevexheha, hadithi nr. 1424.

¹³ Një koment të tillë mund ta gjesh tek Gazaliu, *Ibjau 'ulumi-d-din*, 2/128.

¹⁴ Tirmidhiu, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 5-Babun ma xhae fi-n-nedhari ile-l-mahtubeti, hadithi nr. 1087 dhe e vlerëson si transmetim të mirë; Nesaiu, *Sunen*: 26-Kitabu-n-nikah, 17-Babu ibahati-n-nedhari kable tezvixhi; Ibn Maxheh, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 9-Babu-n-nedhari ile-l-mer'eti idha erade en jetezevexheha, hadithi nr. 1965 dhe 1866; Ahmedî, *Musned*; Darekutni, *Sunen*; Bejhekiu, *Shu'abu-l-Iman* dhe Taberaniu, *El-Mu'xhemu-l-kebiru*.

Këtë transmetim Albani e vlerëson si të besueshëm (Shih: *Sabihu-l-xhami'i-s-sagiri ve zijadetubu*, hadithi nr. 859)

ndryshme ndër dijetarët rreth asaj se çka mund të shikojë i riu në vajzën të cilën e kërkon për fejesë. Kjo përfshinë që nga shikimi i lirë i trupit të saj, flokëve e të ngjashme, deri të shikimi vetëm i fytyrës dhe i shuplakës së duarve. Mendimi i shumicës së dijetarëve të ummetit është se shikimi i çdo pjese tjetër të trupit, duke veçuar fytyrën dhe duart, shpie drejt nxitjes së epsheve dhe i afron drejt amoralitetit.¹⁵

Shikimi dhe njohja e bashkëshortit të ardhshëm duhet të jetë në pajtim me rregullat e Islamit. Nuk guxojnë të vetmohen edhe pasi të fejohen, deri në aktin e martesës, duke u bazuar në fjalët e të Dërguarit të Allahut, s.a.v.s., të cilat i transmeton Xhabiri r.a.: *“Kush e beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit, mos të vetmohet me gruan - nëse nuk është me të ndonjë mahrem - sepse në atë rast, me ta është shejtani!”*¹⁶

Nëse dikush dëshiron informata më të thukta dhe më intime për bashkëshorten e ardhshme, atëherë do të dërgojë ndonjë grua, që ajo në mënyrë të përshtatshme hulumton, ashtu siç ka vepruar Muhamedi s.a.v.s., kur e dërgoi Ummu Sulejmen r.a. për të hulumtuar veçoritë e një gruaje për të cilën ishte i interesuar.¹⁷

Praktika jonë është larg fjalëve të të Dërguarit s.a.v.s. Për fat të keq, vetmimi i të rinjëve është bërë gati një gjë normale. Andaj, nuk duhet të habitemi me rritjen rapide të amoralitetit dhe të

¹⁵ Për këtë shih: dr. Vehbe ez-Zuhejli, *El-Fikhu-l-islamu ve edil-letubu*, 7/18-22.

¹⁶ Imam Ahmedi, *Musned*, 3/339

¹⁷ Ahmedi, Hakimi, Bejhekiu dhe Taberaniu (Shih: Es-Sejjid Sabik, *Fikhu-s-sunne*, 2/25).

pamoralshmëve ndërmjet të rinjëve. Duhet të përpiqemi për ndërrimin e këtyre shprehive joislame dhe sa më shumë që është e mundur t'i afrojmë drejt porosive Islame në këtë drejtim.

NDALOHET FEJESA E ASAJ QË VEÇMË ËSHTË E FEJUAR

Është mëkat që të fejohet vajza e cila veçmë është e fejuar. Ibn Omeri r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut, s.a.v.s. ka tërhequr vërejtjen: *“Mos të bëjë gara dikush prej jush në shitblerjen e tjetrit, e as në fejesë, nëse vëllai i juaj veçmë e ka fejuar, deri sa ai nuk hjek dorë”*¹⁸

AKTI I KURORËZIMIT

Gjëja më e rëndësishme me rastin e aktit të kurorëzimit është oferta dhe pranimi, domethënë që mashkulli t'i ofrojë gruas martesë dhe ajo të pranojë.

¹⁸ Buhariu, *Sahib*: 67-Kitabu-n-nikah, 45-Babun la jahtubu ‘ala hitbeti ehihi hatta jenkiha ev jede’a, hadithi nr. 5142; Muslimi, *Sahib*: 16-Kitabu-n-nikah, 6-Babu tahrimi-l-hitbeti ‘ala hitbeti ehihi hatta je’dhene ev jetruke. Hadithi nr. 1412.

Këtë duhet ta dëgjojnë dy dëshmitarë, që me rastin e çfarëdo mosmarrëveshjeje eventuale, të vërtetojnë se ata dy kanë qenë të kurorëzuar.

Vajza duhet të marrë lejen e prindërve ose mbikqyrësit të saj për martesë. Kjo është e obligueshme te të gjithë Imamët e Medh'hebeve (shkollave juridike), përveç Ebu Hanifes. Kjo bazohet në fjalët e të Dërguarit s.a.v.s., të cilat i transmetojnë Ajsheja dhe Imran r.a.: *“Nuk ka martesë pa mbikqyrës (familjarë) dhe dy dëshmitarëve të drejtë!”*¹⁹

Do të ishte mirë që kurorëzimi të bëhet ditën e premtë, ose në të hyrë të ditës së premtë, ose në Bajram, siç është transmetuar nga gjeneratat e para.²⁰ Është e preferuar që martesë (kurorëzimi) të bëhet në muajin Shevval, duke u bazuar në hadithin e Ajshe r.a. e cila thotë: *“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. u martua me mua në Shevval. Në Shevval më është afruar në shtrat.”* Përndryshe, Ajsheja r.a. u ka preferuar grave që të hyjnë në lidhje martesore dhe intime pikërisht në muajin Shevval.²¹

¹⁹ Bejhekiu, *Sunen*; Albani këtë hadith e vlerëson si të besueshëm. (Shih: *Sabihu-l-xhami'i-s-sagiri ve zjajadetibi*, hadithi nr. 7557)

²⁰ Krahaso: Mr. Muharem Štulanović, *Prva bračna noć i intimni braći život u šerijatskom pravu*, fq. 20

²¹ Tirmidhiu, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 9-Babun ma xhae fi-l-evkatil-leti justehabbu fihe-n-nikah, hadithi nr. 1093 dhe e vlerëson si hasen sahih; Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 53-Babun meta justehabbu-l-bina' bi-n-nisai, hadithi nr. 1990.

MEHRI- DHURATA E MARTESËS

Mehri është dhurata e kurorës të cilin burri është i obliguar t’ia japë gruas me rastin e hyrjes në bashkësinë martesore. Allahu i Lartmadhëruar e urdhëron këtë në Kur’an: “*Grave jepnu dhuratën e kurorës se tyre (niqabin) më të mirë...*”²²

Ajsheja r.a. në pyetjen e Ebu Seleme ibn Abdurrahmanit është përgjigjur se mehri i Pejgamberit, s.a.v.s. ishte pesëqind dirhemë/argjend.²³ Përndryshe, i Dërguari i Allahut s.a.v.s. iu ka propozuar grave që të kërkojnë mehrin sa më të vogël, që ajo të mos jetë pengesë në ngritjen e bashkësive martesore. Kështu, një as’habi i ka kërkuar që të gjejë së paku një unazë të metaltë për ta kurorëzuar atë që e kishte zgjedhur, e kur nuk kishte mundur as atë ta gjejë, atëherë i ka propozuar që t’i mësoj asaj atë që e di nga Kur’ani dhe kjo të jetë mehr!²⁴

Mehri është e drejtë e gruas dhe ajo këtë të drejtë duhet ta shfrytëzojë. Kuptohet, nëse njeriu është i pasur, nga ai mund të kërkojë mehrin më të lartë. Në të vërtetë, mehri është një garancë për ruajtjen e martesës. Nëse njeriu jep mehr të mirë, është shumë më vështirë të vendosë për shkurorezim, sepse me shkurorezim do të humbaste shumë edhe materialisht. Kjo është një prej metodave të ruajtjes së martesës.

²² *Kur’ani*: Nisa, 4.

²³ Muslimi, *Sabih*: 16-Kitabu-n-nikah, 13-Babu-s-Sadak, hadithi nr. 1426

²⁴ Për këtë shih hadithin që e transmeton Buhariu në *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 14-Babu tezvixhi-l-mu’siri, hadithi nr. 5087, shih edhe te Muslimi në *Sabih*: 16-Kitabu-n-nikah, 13-Babu-s-sadak, hadithi nr. 1425.

SHPALLJA E MARTESËS

Është e lejuar që martesë të shpallet me përdorimin e defit. Dhe defi lejohet, ashtu siç thekson shejh Albani, që të përcillet edhe me këngë që nuk kanë përmbajtje të keqe, siç janë gjërat që bijnë në kundërshtim me sheriatin ose përshkrimin e pjesëve të trupit të gjinisë femërore në tekstin e këngës etj.²⁵

Kjo mbështetet në hadithin e të Dërguarit s.a.v.s. të cilin e transmeton Muhammed ibn Hatib el-Xhumehi r.a.: *“Dallimi mes të lejuarës dhe të ndaluarës është përdorimi i defit dhe zërit!”*²⁶

Kur është në pyetje përdorimi i defit, këtu nuk ka kurrfarë dallimesh ndërmjet dijetarëve, mirëpo kur është në pyetje përdorimi i zërit, disa komentojnë se kjo është në të vërtetë, të folurit për atë martesë dhe përhapjen e lajmit se është vënë kurorë ndërmjet dy personave të caktuar, deri te ata të cilët mendojnë se ato janë zëra të gëzimit që dëgjohen me rastin e kurorëzimit, siç janë thënia e ndonjë poezie të lejuar, tregimi i ndodhive të ndryshme të cilat atmosferën e kurorëzimit do ta bënin më të gëzuar e deri te këngët të cilat nuk do të afirmojnë gënjeshtren dhe amoralitetin.²⁷

²⁵ Krahaso: Albani, *Adabu-ç-çefafi fi-s-sunneti-l-mutabhereti*, fq. 179-180

²⁶ Tirmidhiu, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 6-Babun ma xhae fi i'łani-n-nikahi, hadithi nr. 1088 dhe e vlerëson si tranmetim hasen; Nesaiu, *Sunen*: 26-Kitabu-n-nikah, 72-Babu i'łani-n-nikahi bi-s-savti ve darbi-d-deffi; Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 20-Babi i'łani-n-nikah, hadithi nr. 1896.

²⁷ Shih për këtë: El-Mubarekfuri, *Tuhfetu-l-abvedhi*, 4/209.

Është me rëndësi të përmendim se me këtë rast nuk duhet të lejohet çfarëdo largimi nga rregullat islame, siç janë përzierja e burrave dhe grave, sjelljen e këngëtareve etj. Nëse janë prezent edhe meshkujt, atëherë gratë do të rrahin shuplaka dhe nuk do të këndojnë së bashku me meshkujt, me qëllim që të mos vijë deri te nxitja e epsheve dhe anarkisë morale.

Natyrisht, shpallja e martesës ka arsyetimin e saj praktik. Kuptohet se nëse njerëzit kanë dëgjuar gëzim në ndonjë shtëpi, atëherë e dinë se afrimi i dhëndërrit deri te nusja është i ligjshëm dhe i arsyetueshëm me shariat. Mirëpo, nëse njerëzit këtë nuk e dinë, dhe e shikojnë ndonjë burrë me ndonjë grua të panjohur, fillojnë të dyshojnë në moralin e saj. Andaj, ky lloj i përhapjes së lajmit për bashkësinë martesore është i nxitur nga Muhamedi s.a.v.s. me qëllim që çfarëdo mosmarrëveshje, siç janë përgojimet, shpifjet etj., të heshten shumë thjeshtë.

CEREMONIA E DASMËS

Është sunnet që me rastin e kurorëzimit të bëhet ceremonia e dasmës, në të cilën thirren dhe gostiten farefisi, shokët dhe mysafirët tjerë. I Dërguari i Allahut, s.a.v.s., i ka propozuar Abdurrahman ibn Aufit r.a., kur ai është martuar, që të thërë një dele dhe të gostisë pjesëmarrësit, duke i thënë: “*All-llahu të mbuloi me bereqet! Përgatit gostinë qoftë edhe me therjen e një dele!*”²⁸

²⁸ Buhariu, *Sahib*: 67-Kitabu-n-nikah, 56-Babun kejfe jud’a li-l-mutezevixh?, hadithi nr. 5155; Muslimi, *Sahib*: 16-Kitabu-n-nikah, 13-Babu-s-sadak, hadithi nr. 1427 dhe Tirmidhiu, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 10-Babun ma xhae fi-l-velimeti, hadith nr. 1094 dhe e vlerëson si hasen-sahih.

Duhet theksuar se në këtë ceremoni, me rastin e kurorëzimit, është e obligueshme t'i thërrasim edhe të varfërit, me qëllim që të gostiten me ushqimin që është përgatitur me atë rast. Në hadithin të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a. thuhet: *“Është i shëmtuar ushqimi i dasmës në të cilin thirren vetëm pasanikët, kurse liben anësh fukaratë.”*²⁹

DUHET T'I PËRGJIGJEMI FTESËS PËR DASMË

Kur të ftohet muslimani në ndonjë ceremoni të dasmës është obligim që t'i përgjigjet ftesës, nëse në të nuk ka ndonjë gjë të ndaluar dhe të dyshimtë me shariat. Kjo mbështetet në kërkesën e të Dërguarit të Allahut, s.a.v.s., të cilin e transmeton Abdullah ibn Omeri r.a.: *“Kur ndonjëri prej jush ftohet në dasmë, le t'i përgjigjet ftesës!”*³⁰

²⁹ Muslimi, *Sabih*: 16-Kitabu-n-nikah, 16-Babu-l-emri bi ixhabeti-d-da'i ila da'vetin, hadithi nr. 1432.

³⁰ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 71-Babu hakki ixhabeti-l-velimeti ve-d-da'veti, hadithi nr. 5173; Muslimi, *Sabih*: 16-Kitabu-n-nikah, 16-Babu-l-emri bi ixhabeti-d-da'i ila da'vetin, hadithi nr. 1429.

Nëse ndonjë person nuk i përgjigjet ftesës për dasmë - do të mëkatojë, siç thotë Muhamedi s.a.v.s., në hadithin të cilin e transmeton Ebu Hurejre, r.a.: *“Kush nuk përgjigjet në ftesë, do të mëkatojë para Allahut dhe të Dërguarit të Tij!”*³¹

ÇKA DUHET THËNË ÇIFTIT TË POSAMARTUAR?

Për të posamartuarit duhet të bëjmë dua, ashtu siç e ka bërë Muhamedi s.a.v.s., që e transmeton Ebu Hurejre, r.a.: *“Barekallahu lekum ve bareke ‘alejkum ve xheme’a bejnekuma fi-l-hajri!*

Allahu ju mbuloftë me bereqet, qoftë mbi ju bereqeti i Tij dhe ju bashkoftë të dyve në çdo të mirë!”³²

Akil ibn Ebi Talib transmeton se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë se duhet të thuhet kështu:

“Allahummebarik lehum ve barik ‘alejhim!

³¹ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 72-Babun men tereke-d-da’vete ‘asallaha ve resuluhu, hadithi nr. 5177; Muslimi, *Sabih*: 16-Kitabu-n-nikah, 16-Babu-l-emri bi ixhabeti-d-da’i ila da’vetin, hadithi nr. 1432.

³² Tirmidhiu, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 7-Babun ma xhae fima jukalu li-l-mutezevvixhi, hadithi nr. 1091 dhe e vlerëson si hasen-sahih; Ebu Davudi, *Sunen*: 12-Kitabu-n-nikah, 36-Babun ma jukalu li-l-mutezevvixhi, hadithi nr. 2131; Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 23-Babu tehni’eti-n-nikah, hadithi nr. 1905.

O Allah, jepju bereqet dhe vërsho bereqet mbi ta!”³³

* * *

Është gabim të mendohet se Islami i shtrydhë epsheet dhe nuk u lejon njerëzve që të kënaqen me personat e gjinisë së kundërt. Përkundrazi, islami në këtë aspekt është shumë natyral, në mënyrat më të mira lejon shpërthimin e epsheet dhe lejon afrimin e personave të gjinisë së kundërt. A mundet dikush këtë ta thotë pas fjalëve të Allahut xh.sh. drejtuar njerëzve, fjalë këto që paraqesin lirinë e afrimit të ndërsjellë të të martuarve dhe mundësinë e tyre që të krijojnë atmosferën më tërheqëse, pa kurrfarë kufizime: *“Gratë tuaja janë vendmbjellje e juaj, afrohuni vendmbjelljes suaj si të dëshironi...”*³⁴

Të vetmen gjë që e kërkon Islami në aktin intim është largimi nga marrëdhëniet jo të natyrshme, akteve perverse dhe dhunës shtazarake.

Në fjalët e ardhshme do të tentojmë të shpjegojmë kulturën e sjelljes para dhe me rastin e aktit intim, me qëllim që të vërtetojmë se Islami nuk i ngushton ndjenjat e çifteve bashkëshortore dhe se ju hapë mundësi të shumta të kënaqësive, ndjenjën e veçantë të kënaqësisë të cilën Allahu i Mëshirshëm e ka vendosur në çdo person, mirëpo me një kusht të vetëm, që të mos kalojnë kufirin e natyrshmërisë, të cilin Zoti i botërave e ka vendosë.

³³ Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 23-Babu tehni’eti-n-nikah, hadithi nr. 1906.

³⁴ *Kur’ani*: Bekare, 223

FALJA E DY REKATEVE NAMAZ PARA MARRËDHËNIEVE INTIME

Është mirë që të posamartuarit, para se të hyjnë në marrëdhënie intime, të falin dy rekate namaz nafile. Namazin duhet falur së bashku (në xhema), kështu që burri do të dalë më përpara ndërsa gruaja më pas tij. Kjo është mënyra më e mirë që bashkëshortët të fillojnë jetën e re me sexhde dhe nënshtrim ndaj Zotit të tyre dhe se dashuria e ndërsjellë prej fillimit të nisë me plotësinë e saj.

Kjo bazohet në thënien të cilën e transmeton Shekiku, në të cilin theksohet se një njeri me emrin Ebu Harith, i cili, siç pohon Imam Dhehebiu ishte as'hab i të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.³⁵, ishte martuar me një vajzë dhe kishte frikë se ajo, eventualisht mund mos ta dojë, atëherë me këtë rast Abdullah ibn Mes'udi r.a. ia dha këtë këshillë: *“Afria dhe harmonia vijnë prej Allahut ndërsa ndarja dhe joharmonia janë prej shejtanit, i cili dëshiron që t’ua bëjë të urrejtur atë që ua ka lejuar Allahu. Andaj, urdhëro gruan tënde që të falë me ty dy reqate namaꝑ!”*³⁶

³⁵ Për këtë pohim të Dhehebiut shih: Albani, *Adabu-ꝑ-ꝑefafi fi-s-sunneti-l-mutabhereti*, fq. 95.

³⁶ Këtë transmetim e shënon Ebu Bekr ibn Ebi Shejbe në *Musannefin* e tij; Abdurrezaku në *Musannefin* e tij, me zingir transmetuesish të besueshëm, si dhe Taberaniu në *Mu'xhemu-l-ersat*, me transmetues të besueshëm. (Shih për këtë: *Adabu-ꝑ-ꝑefafi fi-s-sunneti-l-mutabhereti*, fq. 95-96)

SHPREHJA E DASHURISË NDAJ GRUAS

Është mustehab që burri të jetë i sjellshëm ndaj bashkëshortes së tij, ndërsa këtë duhet dëshmuar, posaçërisht në natën e parë të martesës. Kjo mund të manifestohet me ndonjë dhuratë të cilën bashkëshortja e do, me ndonjë lule ose me ndonjë pije, e të ngjashme, siç ka vepruar i Dërguari s.a.v.s. ndaj Ajshes r.a. kur i është afruar në natën e parë. Në të vërtetë Esma' bint Jezid r.a. transmeton se Pejgamberi, s.a.v.s. në natën e parë të martesës, duke treguar mirësjellje të veçantë ndaj Ajshes r.a., i ka ofruar një enë me qumësht, kështu që momentet e para të lidhjes së tyre të jenë më të afërta dhe më të mira.³⁷

TË VENDOSËT DORA NË KOKËN E GRUAS DHE TË BËHET DUA

Është e preferueshme që në natën e parë të martesës të vendoset dora në kokën e bashkëshortes - edhe atë në fillim në kokës ku dalin flokët - të thuhet besmelja dhe të lutet All-llahu për bereqet, ashtu siç ka propozuar i Dërguari, s.a.v.s., në hadithin të cilin e transmeton Abdullah ibn 'Amr r.a.: *“Kur ndonjëri prej jush martohet, le ta vendosë dorën e tij në kokën e saj, le të përmend emrin e Allahut të*

³⁷ Ahmedi, *Musned*, 6/438, 452, 543 dhe 458; Humejdi, *Musned*, 2/61.

Lartësuar, le të lutet për bereqet dhe le të thotë: O Allah, më jep prej saj mirë, atë të mirë me të cilën Ti e ke krijuar, ndërsa më ruaj nga e keqja e saj, e keqja me të cilën Ti e ke krijuar!”³⁸

ÇKA DUHET THËNË ME RASTIN E AFRIMIT TE GRUAJA?

Para aktit intim bashkëshortët duhet të thonë duanë në të cilën do ta lusin Allahun e Lartësuar, që prej tyre dhe prej pasardhësit të mundshëm të tyre, të largojë shejtanin dhe të keqen e tij. Kjo bazohet në hadithin autentik, të cilin prej Muhamedit s.a.v.s. e transmeton Abdullah ibn Abbas r.a.:

“Bismil-lah! Allahumme xhennibne-sh-shejtane ve xhennibi-sh-shejtane ma rezaktena!

Në emër të Allahut! O Allah, largo shejtanin prej neve dhe prej atij të cilin ke dhënë të niset (fëmijës)!

Nëse Allahu jep që me atë rast të niset ndonjë fëmijë, shejtani nuk do t’i bëjë dëm!”³⁹

³⁸ Buhariu, *Efalu-l-’ibad*, fq. 77; Ebu Davudi, *Sunen*: Kitabu-n-nikah, 46-Babu fi xhami’i-n-nikah, hadithi nr. 2160.

DUHET PATUR KUJDES TË MOS KTHEHEN KAH KIBLA

Bashkëshortët të kenë vëmendjen, siç tërheqin vërejtjen disa dijetarë muslimanë, që me rastin e aktit seksual të mos jenë të kthyer kah Kibla, si respekt ndaj saj.⁴⁰

PARA MARRËDHËNIEVE INTIME JEMI TË OBLIGUAR TË PËRGATITEMI

Bashkëshorti duhet të gjejë mënyra që psikologjikisht ta përgatisë gruan për aktin seksual. Ai duhet të mundohet të thejë turpin e saj, t'i mbjellë siguri dhe vetbesim, posaçërisht në natën e parë të martesës. Në të vërtetë, shumë vajza kanë frikë të madhe nga nata e parë e martesës. Nëse burri nuk është i kujdesshëm në natën e parë, kjo mund të rezultojë me shumë pasoja të padëshirueshme të cilat mund të zgjasin ose të mbesin të përhershme, sikur frigjediteti, frika nga akti seksual e të tjera.

³⁹ Buhariu, *Sahib*: 67-Kitabu-n-nikah, 66-Babun ma jekulu-r-rexhulu idha eta ehlehu, hadithi nr. 5165; Muslimi në *Sahib*: 16-Kitabu-n-nikah, 18-Babun ma justehabbu en jekulehu 'inde-l-xhima'i, hadithi nr. 1434, dhe të tjerët.

⁴⁰ Shih për këtë: Gazaliu, *Ihja 'ulumi-d-din*, 2/147.

Prandaj një fjalët e mira, afrimi i këndshëm, përkdheljet dhe puthjet mund të jenë hyrja më e mirë në vetë aktin seksual dhe pas vetes nuk do të lënë pasoja të padëshirueshme, siç mund të ndodhte me hyrjen direkte në akt, me lëvizje të shpejta dhe të vrazhda dhe me kryerjen e vetë aktit pa kurrfarë përgatitje.

Se sa janë të urta fjalët e të Dërguarit të Allahut, s.a.v.s. të cilat i transmeton Enes ibn Malik r.a.: “Asnjëri prej jush le të mos i afrohet gruas së tij, ashtu siç e bëjnë kafshët! Në mesin e atyre dyve le të jetë një emisar! Kanë pyetur: E çka është ajo o i Dërguari i Allahut? Ai është përgjigjur: Ajo është të folurit dhe puthja!”⁴¹

Për fat të keq, shumë muslimanë për marrëdhëniet intime mësojnë nga romanet, nga serialet televizive apo nga revistat erotike, ndërsa reçeta e vërtetë për martesë të suksesshme dhe për marrëdhënie të drejta intime është i Dërguari ynë, s.a.v.s. që sa shekuj?! Athua a ka dikund aq ngrohtësi, ëmbëlsi dhe urti dhe aq brengë për ruajtjen e martesës, ashtu siç gjejmë në fjalët e tij?!

⁴¹ Ebu Mensur Ed-Dejlemi, *Musnedu-l-firdens*.

Në realitet këtë transmetim Hafidh El-‘Iraki e vlerëson të dobët. (Shih: *Ihjan ‘ulumu-d-din*, 2/148).

CILA POZITË ËSHTË E LEJUAR GJATË MARRËDHËNIEVE INTIME?

Është e lejuar që me rastin e marrëdhënies intime t'i afrohemi bashkëshortes nga cilado anë: nga para, nga prapa ose prej anësh, edhe pse më e natyrshme, siç përmendet në disa thënie, është që gruaja të jetë e shtrirë në shpinë ndërsa burri mbi të.

Domethënë është i lejuar çdo pozitë, me kusht që marrëdhëniet të kryhen në organin gjenital të gruas. Xhabiri r.a. transmeton se çifutët kanë folur se fëmija do të lindë i mangët tek ai njeri që i afrohet gruas nga prapa, dhe për këtë është shpallur ajeti: *“Gratë tuaja janë vendmbjellje e juaj, afrobuni vendmbjelljes suaj si të dëshironi...”*⁴². Me këtë rast i Dërguari s.a.v.s. ka sqaruar: *“Edhe nga para edhe nga mbrapa, mirëpo me kusht të kryhet në organin gjenital të gruas!”*⁴³

⁴² *Kur’ani*: Bekare, 223

⁴³ Buhariu, *Sahib*: 65-Kitabu-t-tefsir, 39-Babun: *“Nisaukum barsun lekum...”*, hadithi nr. 4528; Muslimi, *Sahib*: 16-Kitabu-n-nikah, 19-Babu xhevazi xhima’a imreetihi fi kubuliha, hadithi nr. 1435; Ebu Davudi, *Sunen*: Kitabu-n-nikah, 46-Babun fi xhami’i-n-nikah, hadithi nr. 2163 dhe 2164.

NDALIMI I MARRËDHËNIEVE NË ANUS (VRIMËN ANALE)

Është haram që të kryhen marrëdhëniet intime në vrimën anale, në bazë të shumë haditheve të Muhamedit s.a.v.s.. Ebu Hurejre r.a. transmeton se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: *“Është i mallkuar ai që kryen marrëdhënie intime me gruan e tij në vrimën anale!”*⁴⁴ Në transmetimin të cilin e përcjellin Ibn Abbasi dhe Ebu Hurejre r.a. thuhet: *“Allahu nuk do të shikojë në njeriun i cili kryen marrëdhënie intime në vrimën anale!”*⁴⁵

LARJA PAS MARRËDHËNIEVE INTIME

Është e obligueshme larja pas marrëdhënieve intime. Në të vërtetë, pasi të vijë deri te prekja (takimi) e organeve gjenitale, qoftë edhe pa ejakuluar, larja ose gusli bëhen të obligueshme. Larja mund të bëhet bashkarisht, ashtu siç e ka bërë i Dërguari i Allahut, s.a.v.s. në transmetimin të

⁴⁴ Ebu Davudi, *Sunen*. Kitabu-n-nikah, 46-Babun fi xhami'i-n-nikah, hadithi nr. 2162; Ahmedi, *Musned*, 2/444 dhe 479.

⁴⁵ Ibn Maxhe, *Sunen*. 9-Kitabu-n-nikah, 29-Babu-n-nehji 'an itjani-n-nisai fi edbarihinne, hadithi nr. 1923; Ahmedi, *Musned*, 2/272.

cilin e përcjell Ajsheja r.a.: *“Jam larë me të Dërguarin s.a.v.s. nga një enë, e ai më tejkalonte në marrjen e ujit nga ajo enë, kështu që thashë: Më ler edhe mua! Më ler edhe mua! Ka thënë: Kemi qenë të dytë xhunub.”*⁴⁶

Domethënë, pasi që burri dhe gruaja bashkarisht mund të lahen, kjo tregon se ata lirisht mund të shikojnë dhe të prekin pjesët e tyre, të turpshme, të trupit. Dijetarët muslimanë, duke u mbështetur në hadithin e të Dërguarit të Allahut, s.a.v.s. të cilin e transmeton Behz ibn Hakim, nga babai i tij ndërsa ai prej gjyshit të tij, se e ka pyetur të Dërguarin s.a.v.s.: *“Çka është me vendet tona të turpshme të cilat i tregojmë?”* Ai është përgjigjur: *“Ruaji vendet tuaja të turpshme nga secili, përveç prej gruas tënde...”*⁴⁷ kanë ardhur në përfundim se është e lejuar që burri dhe gruaja të shikojnë dhe të prekin vendet e turpshme. Kështu, për shembull, Ibn Haxheri mendon se ky hadith udhëzon në lejimin e shikimit të vendeve të turpshme të bashkëshortes (bashkëshortit),⁴⁸ ndërsa Ibn Urve el-Hanbeli mendon se me këtë lejohet shikimi, prekja dhe kënaqja në atë pjesë të trupit, ngjashëm siç mundemi të shikojmë të bashkëshorti (bashkëshortja) pjesët tjera të trupit, preken apo të kënaqemi me to!⁴⁹

⁴⁶ Buhariu, *Sahib*: 5-Kitabu-l-gusli, 2-Babu gusli-r-rexhuli me’a imre’etih, hadithi nr. 250; Muslimi, *Sahib*: 3-Kitabu-l-hajdi, 10-Babu-l-kadri-l-mustehabbi mine-l-mai fi gasli-l-xhenabeti, hadithi nr. 320 dhe 321.

⁴⁷ Tirmidhiu, *Sunen*: 44-Kitabu-l-edeb, 22-Babun ma xhae fi hifdhi-l-avreti, hadithi nr. 2769 dhe e vlerëson si transmetim hasen.

⁴⁸ Krahaso: El-Mubarekfuri, *Tuhfetu-l-abvedhi*, 8/54.

⁴⁹ Shih për këtë: *Adabu-ş-şefafi fi-s-sunneti-l-mutabbereti*, fq. 111.

SI TË MARRIM GUSUL?

Pas marrëdhënieve intime, guslin duhet marrë ashtu siç ka vepruar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. Në të vërtetë, ai, siç thekson Imam Buhariu në një thënie të Ajshes r.a. dhe Mejmunes r.a., së pari ka larë duart, ndërsa në një thënie tjetër edhe organin gjenital, pastaj lante gojën dhe fytin dhe mirrte abdest siç mirret abdesti për namaz. Pas kësaj lante kokën e pas saj tërë trupin, kështu që askund të mos mbesë ndonjë pjesë e terur.⁵⁰

A DUHET TË MIRRET GUSËL PAS ÇDO MARRËDHËNIE INTIME?

Nëse dikush i afrohet gruas dhe dëshiron të njëjtën ta bëjë për së dyti herë, atëherë nuk duhet patjetër që pas çdo marrëdhënie intime të marrë gusël, por këtë duhet ta bëj në fund. Kushti i vetëm (për vazhdimin) është që patjetër të marrë abdest, ashtu siç merr për namaz dhe të lajë organin gjenital, e më pas t'i afrohet sërish gruas së tij.

⁵⁰ Buhariu, *Sabih*: 5-Kitabu-l-gusli, 1-Babu-l-vudui kable-l-gusli, hadithi nr. 248 dhe 5-Babu-l-gusli merreten vahideten, hadithi nr 257.

Ebu Se'îd el-Hudri r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Nëse dikush i afrohet gruas së tij, dhe këtë dëshiron ta përsërisë, le të marrë abdest!”⁵¹

Abdullah ibn Ebi Kajs e ka pyetur Ajshen r.a.: “Si ka vepruar i Dërguari s.a.v.s. kur ka qenë xhunub? A është larë para se të flinte apo ka fjetur para se të lahet? Ajo është përgjigjur: “Ka vepruar edhe njëerën edhe tjetrën, nganjëherë është larë, e pastaj ka fjetur, e nganjëherë ka marrë abdest e pastaj ka fjetur. Abdullah ibn Ebi Kajs atëherë tha: “Falënderuar qoftë Allahu që e ka bërë këtë fleksibile!”⁵²

Gjithashtu, nëse personi i cili ka marrëdhënie intime dhe nuk është në gjendje menjëherë të lahet, ndërsa dëshiron të flejë ose të hajë, le të marrë abdest, pastaj do të hajë ose do të flejë, e më vonë do të lahet. Ajsheja r.a. transmeton se i Dërguari, s.a.v.s. nëse ishte xhunub, ndërsa ka pasur dëshirë të hajë ose flejë, ka marrë abdest siç mirret abdesti për namaz.⁵³

⁵¹ Muslimi, *Sahib*: 3-Kitabu-l-hajdi, 6-Babu xhevazi nevmi-l-xhunubi, hadithi nr. 308.

⁵² Po aty, hadithi nr 307

⁵³ Po aty, hadithi nr. 305

KUSH KA MË SHUMË SE NJË GRUA, A DUHET TË LAHET PAS AFRIMIT TË SECILËS GRUA?

Nëse ndokush ka më shumë se një grua dhe për një natë ka kontakt me secilën, nuk është e obligueshme që të lahet pas çdonjëres. Atij i është mundësuar që pas afrimit të njëra grua, të lajë organin gjenital dhe të marrë abdest, e pastaj t'i afrohet gruas tjetër. Kështu nganjëherë ka vepruar Pejgamberi s.a.v.s.. Enes r.a. transmeton se Muhammedi a.s. i është afruar grave të tij me një të larë.⁵⁴

Ka edhe transmetime tjera në të cilat theksohet se Muhammedi a.s. ka marrë gusël, pas çdo afrimi të gratë e tij, pa marrë parasysh se atë e ka bërë gjatë një nate.

⁵⁴ Buhariu, *Sahib*: 67-Kitabu-n-nikah, 102-Babun men tafe 'ala nisaihi fi guslin vahidin, hadithi nr. 5215; Muslimi, *Sahib*: 3-Kitabu-l-hajdi, 6-Babu xhevazi nevmi-l-xhunubi, hadithi nr. 309.

A ËSHTË E LEJUAR RUAJTJA NGA SHTATZANIA?

Është e lejuar që gjatë marrëdhënieve intime, nëse është edhe gruaja e pajtimit, që të nxirret organi gjenital i mashkullit para ejakulimit, me qëllim të ndalimit të shtatzënisë. Për këtë kuptohet se duhet të ketë arsytim. Përndryshe, në të kundërtën, preferohet hedhja e spermës në organin gjenital të gruas dhe nxitja e lindjes, për të cilin transmetohen shumë hadithe të të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., aq sa ruajtja nga shtatzënia nganjëherë quhet *el-ved'ul-hafijj - vdekeje e fshehtë*.⁵⁵

Mirëpo, hadithet autentike në mënyrë të prerë flasin për vetë lejimin e ndërprerjes natyrore të shtatzënisë, në atë mënyrë që sperma në momentin e ejakulimit të hedhet jashtë organit gjenital të gruas, që është edhe qëndrim i të katër shkollave juridike islame.⁵⁶

Xhabiri r.a. transmeton: “Jemi ruajtur prej shtatzënisë në kohën e të Dërguarit s.a.v.s.” ndërsa në një transmetim tjetër thotë: “Jemi ruajtur prej shtatzënisë derisa ishte duke zbritur Kur’ani!”⁵⁷

⁵⁵ Shih për këtë: Muslimi, *Sahib*: 16-Kitabu-n-nikah, 24-Babu xhevazi-l-gileti ve hije va’u-l-murdi’i ve kerahetu-l-‘azli, hadithi nr. 1442.

⁵⁶ Shih: Mr. M. Štulanović, vep.cit., fq. 32.

⁵⁷ Buhariu, *Sahib*: 67-Kitabu-n-nikah, 96-Babu-l-‘azli, hadithi nr 5207 dhe 5208; Muslimi, *Sahib*: 16-Kitabu-n-nikah, 22-Babu hukmi-l-‘azli, hadithi nr. 1440.

ËSHTË E NDALUAR T'I RRËFESH DIKUJT PËR MARRËDHËNIET INTIME

Është rreptësisht e ndaluar që të tjerëve t'u tregosh atë që përjeton gjatë marrëdhënieve intime ose të përshkruash vet aktin. Muhamedi s.a.v.s. në një hadith të cilin e transmeton Ebu Se'id el-Hudriu r.a. këtë qartë e tregon: *“Me të vërtetë, njerëz me pozitive më të keqe tek Allahu në Ditën e Gjykimit janë ata që bëjnë marrëdhënie intime dhe e përhapin atë!”*⁵⁸

KULTURA E SJELLJES SË BURRIT NDAJ GRUAS

Allahu i Lartëmadhërishëm çdo detaj të jetës së njeriut e ka përcaktuar që të jetë në pajtim me ligjet e Tij. Duke e ditur natyrën e njeriut, të cilin edhe e ka krijuar, Ai ka caktuar rregulla të cilat mundësojnë që njeriu të ruajë dhe të mbrojë natyrën e tij. Pasi që martesë është institucion që ruan familjen, Islami i jep rëndësi të veçantë. Nga kjo, Allahu xh.sh. në shumë ajete dhe nëpërmjet të Dërguarit të Tij, s.a.v.s. ka caktuar drejtime të qarta se si të veprojë njeriu në atë segment të jetës, me qëllim të ruajtjes së martesës, forcimit të familjes dhe kështu të shërojë shoqërinë në tërësi.

⁵⁸ Muslimi, *Sabih*, 16-Kitabu-n-nikah, 21-Babu tahrimi ifshai sirri-l-mer'eti, hadithi nr 1437.

Prej rreshtave në vazhdim do të shihni se Islami ka vendosur rregulla konkrete në aspektin e respektimit të ndërsjellë të bashkëshortëve. Bashkëshortët janë të obliguar të jetojnë në pajtim me ato rregulla, dhe në këtë mënyrë, të ruajnë familjen e shëndoshe dhe vitale, që është parakusht për një shoqëri të shëndoshë dhe vitale.

SJELLJA E MIRË NDAJ GRUAS

Burri, ndaj gruas obligohet me:

Burri duhet të mundohet të ndërtojë marrëdhënie të mira ndaj gruas së tij, sepse i Dërguari i Allahut, s.a.v.s. këtë e ka nxitur në shumë thënie të tij. Kështu në transmetimin e Ebu Hurejres r.a. Muhammedi a.s., ka thënë: *“Besimtari më i plotë është ai i cili ka sjellje të mirë, ndërsa më të mirë në mesin tuaj janë ata të cilët sillen më së miri ndaj grave të tyre!”*⁵⁹

Në përmbledhjen e Ibn Maxhes përmenden dy transmetime të përmbajtjes së njëjtë. Në transmetimin e Ibn Abbasit, i Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Më të mirët ndër jush janë ata të cilët janë më të mirët ndaj grave të tyre, ndërsa unë jam më i miri ndaj grave të mia!”*⁶⁰ Në transmetimin e Abdullah ibn

⁵⁹ Tirmidhiu, *Sunen*: -Kitabu-r-reda’a, 11-Babun ma xhae fi hakki-l-mer’eti ‘ala zevxhiha, hadithi nr 1162 dhe e vlerëson si hasen sahih; Ahmedi, *Musned*, 2/250 dhe 472.

⁶⁰ Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 50-Babu husni mu’ashereti-n-nisai, hadithi nr. 1977.

Amër ibn Asit r.a. i Dërguari s.a.v.s. thotë: “Më të mirët ndër jush janë ata të cilët janë më të mirë ndaj grave të tyre!”⁶¹ Në haxhin e lamtumirës Muhamedi, s.a.v.s. i ka porositur muslimanët në bazë të transmetimit të Amr ibn el-Ahvesit r.a.: “Dhe silluni mirë me gratë tuaja!”⁶²

TË KUPTOSH NEVOJAT DHE ASPIRATAT E SAJ

Burri është i obliguar që të kuptojë gruan dhe nevojat e saj, dëshirat dhe aspiratat e saj. Për këtë argument më të mirë gjejmë në jetën e të Dërguarit të Allahut, s.a.v.s. Në të vërtetë, Ajsheja r.a. transmeton se është fejuar për të Dërguarin e Allahut, s.a.v.s. shumë e re dhe se ka pasur qejf të luajë me shoqet e saj, dhe i Dërguari s.a.v.s. i ka kërkuar shoqet e saj dhe i ka nxitur që të vijnë dhe të luajnë me të (me Ajshen).⁶³

⁶¹ Po aty, 1978.

⁶² Tirmidhiu, *Sunen*: 10-Kitabu-r-reda’a, 11-Babun ma xhae fi hakki-l-mer’eti ‘ala zevxhiha, hadithi nr. 1163 dhe e vlerëson hasen sahih; Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 3-Babu hakki-l-mer’eti ‘ale-z-zevxhi, hadithi nr. 1851.

⁶³ Shih këtë transmetim interesant tek Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 50-Babu husni mu’ashereti-n-nisai, hadithi nr. 1982.

Është edhe një transmetim i ngjashëm i Ajshes r.a. kur ka shikuar në xhami vallen e abisinasve me shtiza, dhe i Dërguari s.a.v.s. këtë nuk ia ka ndaluar.⁶⁴

Ajsheja r.a. pohon se i Dërguari s.a.v.s. ka bërë gara me të në vrapim. Nganjëherë ajo ka fituar e nganjëherë ai.⁶⁵

Loja dhe zbavitja me gruan janë hobi të lejuara me shariat. Kështu, Xhabir ibn Abdullah r.a. thotë se njeriu do të shpërblehet vetëm për disa lloje të hobive. Në mesin e tyre janë edhe loja dhe zbavitja me gruan, dresimi (stërvitja) i kuajve dhe mësimi i notit.⁶⁶

T'I NDIHMOJË GRUAS NË PUNË

Burri duhet t'i ndihmojë gruas në shumë punë të shtëpisë, kur ajo nuk mund t'i mbërrijë ato. El-Esvedi e ka pyetur Ajshen r.a.: *“Çka ka punuar i Dërguari s.a.v.s. në shtëpi? Ajo është përgjigjur: “Ndihmonte familjes, ndërsa kur dëgjonte ezanin, shkante.”*⁶⁷

⁶⁴ Buhariu, *Sahih*: 67-Kitabu-n-nikah, 114-Babu nedhari-l-mer'eti lie-l-habeshi ve nahvehum min gajri ribetin, hadithi nr. 5236.

⁶⁵ Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 50-Babu husni mu'ashereti-n-nisai, hadithi nr. 1079.

⁶⁶ Taberaniu, *El-Mu'xhemu-l-Kebiru*. (Shih: Albani, *Sahibu-l-xhami'i-s-sagiri ve zjjadetubu*, hadithi nr. 4534, shih po ashtu: *Adabu-x-zefafi fi-s-sunneti-l-mutabhereti*, fq. 277.)

Urve transmeton se e ka pyetur Aishen r.a. lidhur me atë se çka ka punuar i Dërguari i Allahut, s.a.v.s. në shtëpi, ndërsa ajo i është përgjigjur: “*Armonte papuçet dhe rrobot e tij.*”⁶⁸

Në pyetjen se çka ka punuar i Dërguari s.a.v.s. në shtëpi, Ajsheja r.a. njëherë është përgjigjur: “*Ishte njeri sikur të tjerët: ka arnuar rrobot e tij, ka mjelur delen dhe i ka shërbyer vetvetes!*”⁶⁹

Domethënë, nuk do të bëhet *papuçexhi* ai i cili i ndihmon gruas në punët e shtëpisë, kur ajo nuk është në gjendje t’i bëjë vetë, mirëpo do të jetë një gjest i mirë i burrit i cili gjest do të forconte edhe më shumë dashurinë mes bashkëshortëve, siç ka vepruar Muhammedi s.a.v.s.

TË SIGUROJË FURNIZIMIN

Burri është i obliguar në bazë të rregullave islame, që të mbajë gruan dhe të gjejë mënyra të furnizojë familjen. Gruaja, edhe nëse ka mjete, nuk është e obliguar t’i shpenzojë për plotësimin e nevojave familjare. Andaj mashkulli në trashëgimi merr dy herë më shumë, që të ketë mundësi për këtë. Ai është i obliguar për punët jashtë shtëpisë me qëllim që të arrijë sigurimin e furnizimit.

⁶⁷ Buhariu, *Sahib*: 69-Kitabu-n-nefekat, 8-Babu hidmeti-r-rexhuli fi ehlihi, hadithi nr. 5363.

⁶⁸ Buhariu, *El-Edebu-l-mufredu*. 247-Babun ma ja’melu-r-rexhulu fi bejtih, hadithi nr. 540.

⁶⁹ Buhariu, *El-Edebu-l-mufredu*. 247-Babun ma ja’melu-r-rexhulu fi bejtih, hadithi nr. 541; Ahmedi, *Musned*, 6/256; Tirmidhiu, *Esb-Sbemailu*, 2/185; Ibn Hibban, *Sahib*, hadithi nr. 2136; Bejhekiu, *Delailu-n-nubuvve*, 1/328 dhe Ebu Nu’ajm, *Hil’jetu-l-evlija*, 8/331.

Se sa është ngritur furnizimi i familjes në fjalët e Muhamedit s.a.v.s., më së miri do të shohim nga hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a.: *“Nga paratë që i jep: në rrugë të Allahut, apo për lirimin e ndonjë robi, apo për ndihmën e ndonjë të varfëri, apo furnizimin e familjes tënde, shpërblimin më të madh do ta kesh për ato që shpenzon për familjen.”*⁷⁰.

Në hadithin e Ebu Mes’ud el-Bedriut r.a. i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. thotë: “Kur njeriu shpenzon para për mirëmbajtjen e familjes së tij, duke pretenduar me këtë kënaqësinë e Allahut, i shkruhet sikur ka ndarë sadaka!”⁷¹

Në transmetimin e Sa’d ibn Ebi Vekkasit r.a. i Dërguari s.a.v.s. thotë: “Për çdo dinar të shpenzuar, duke dashur kënaqësinë e Allahut, do të jesh me të vërtetë i shpërblyer nga Allahu, madje edhe për kafshatën të cilën e vendosë në gojën e gruas tënde!”⁷²

Burri duhet posaçërisht të ketë kujdes se ajo me të cilën e furnizon gruan, gjegjësisht familjen, të jetë e fituar me hallall. Gratë e gjeneratës së parë të muslimanëve, i kanë nxitur burrat e tyre në fitimin hallall duke u thënë: *“Ruajuni fitimit haram, sepse ne mund të durojmë urinë dhe etjen por nuk mund të durojmë zjarrin!”*⁷³

⁷⁰ Muslim, *Sahih*: 12-Kitabu-z-zekat, 12-Babu fadli-n-nefekati ‘ale-l-‘ijali ve memluki, hadithi nr. 995.

⁷¹ Buhariu, *Sahih*; 69-Kitabu-n-nefekati, 1-Babu fadli-n-nefekati ‘ale-l-ehli, hadithi nr. 5351 dhe Muslimi, *Sahih*: 12-Kitabu-z-zekat, 14-Babu fadli-n-nefekati ve-s-sadekati ‘ale-l-akrebine ve-z-zevxhi ve-l-evladi ve-l-validejni, ve lev kanu mushrikin, hadithi nr. 1002.

⁷² Buhariu dhe Muslimi (Shih: Imam Neveviu, *Rijadu-s-salihin*, hadithi nr 292.)

⁷³ Gazaliu, *Ihjaw ‘ulumi-d-din*, 2/162.

BËHU I DREJTË NDAJ GRAVE

Burri duhet të jetë i drejtë ndaj gruas së tij. Posaçërisht nëse burri ka më shumë gra. Prej këtu, burri duke ditur për ndjeshmërinë e gruas, duhet shumë të ketë kujdes në plotësimin e asaj për çka është i obliguar. Kështu duhet të ketë kujdes në ushqimin, veshjen e tyre e të ngjashme dhe në këtë aspekt të mos bëjë kurrfarë dallimi ndërmjet tyre.

Gjithashtu, ai duhet të ketë kujdes për orarin e qëndrimit të secila grua. I Dërguari i Allahut s.a.v.s., siç thekson Ajsheja r.a. në një hadith autentik, ka shkuar te gruaja tjetër pas faljes së namazit të ikindisë.⁷⁴

Nëse burri është i padrejtë dhe do të linte ndonjërin prej grave të tij, do të ballafaqohet me pasoja të padëshirueshme në Ditën e Gjykimit, siç tërheq vërejtjen i Dërguari i Allahut, s.a.v.s. në transmetimin e Ebu Hurejres r.a.: *‘Kush i ka dy gra, dhe nuk sillet në mënyrë të barabartë ndaj të dyjave, do të vijë në Ditën e Gjykimit me një anë e cila do t’i jetë e lakuar!’*⁷⁵

⁷⁴ Buhariu, *Sahih*: 67-Kitabu-n-nikah, 103-Babun duhuli-r-rexhuli ‘ala nisaihi fi-l-jevmi, hadithi nr. 5261.

⁷⁵ Tirmidhiu, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 41-Babun ma xhae fi-t-tesvijeti bejne-d-deriri, hadithi nr. 1141; Nesaiu, *Sunen*: 36-Kitabu ‘ashereti-n-nisai, 2-Babun mejli-r-rexhuli ila ba’di nisaihi dune ba’din, dhe Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 47-Babu-l-kismeti bejne-n-nisai, hadithi nr. 1696.

TE BEQARESHA TË QËNDROJË SHSTATË DITË, NDËRSA TE E MARTUARA TRE DITË

Nëse një njeri marton beqareshë (vajzë të virgjër), por ka më shumë gra, atëherë te ajo do të qëndrojë shtatë ditë, e pastaj le të shkojë sipas orarit të gratë tjera. Mirëpo, nëse marton ndonjë grua veçmë të martuar, te ajo do të qëndrojë tre ditë, e pastaj mund të shkojë të gratë tjera sipas orarit të caktuar. Kjo bazohet në transmetimin e Enes ibn Malikut r.a. nga i Dërguari s.a.v.s..⁷⁶

Ummu Selema r.a. transmeton se i Dërguari s.a.v.s. ka kaluar te ajo tre ditë kur ishte martuar me të, pasi që kishte mbetur vejushë.⁷⁷

⁷⁶ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 100-Babun idha tezevexhe-l-bikre ale-s-sejjibi, hadithi nr. 5213; Muslimi, *Sabih*: Kitabu-r-reda'a, 12-Babu kadri ma testehhikuhu-l-bikru ve-s-sejjibu min ikameti-z-zevxhi 'indeha 'akbe-z-zefafi, hadithi nr. 1461.

⁷⁷ Shih: Muslim, *Sabih*: Kitabu-r-reda'a, 12-Babu kadri ma testehhikuhu-l-bikru ve-s-sejjibu min ikameti-z-zevxhi 'indeha 'akbe-z-zefafi, hadithi nr. 1460.

DASHURIA MË E MADHE NDAJ DISA GRAVE

Njeriu i cili jeton në poligami duhet të jetë i drejtë në atë çka i është lejuar, sikur qëndrimi i barabartë të gratë e tij, mosneglizhimi i asnjërës prej tyre dhe marrëdhëniet e ngjashme ndaj tyre kur është në pyetje veshja, ushqimi etj. Mirëpo, kur është në pyetje dashuria ndaj tyre, atëherë kjo nuk është më në kompetenca të njeriut, sepse All-llahu mbjellë dashurinë në zemrën e njeriut, siç ka thënë i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. e të cilën e transmeton Ajsheja r.a., pasi që ka qenë i barabartë ndaj grave të tij: *“O Allahu im, kejo është ndarja në atë që është në fuqinë time. Për mos më ngarko me atë çka është në fuqinë Tënde e jo timen!”*⁷⁸ Këtu mendohet në dashurinë e cila ndjehet në zemër ndaj ndonjërës prej grave.

All-llahu xh.sh këtë qartë e përmend në Kur’anin famëmadh: “Ju kurrresi nuk do të mund ta mbani drejtësinë mes grave edhe nëse përpiqeni...”⁷⁹

Dihet se i Dërguari s.a.v.s. dashuri të veçantë ka kultivuar ndaj Ajshe r.a. Këtë të gjitha gratë tjera të tij e kanë vërejtur dhe e kanë pranuar, ndërsa e kanë ditur se ai është më i drejti ndaj tyre.

⁷⁸ Ebu Davudi, *Sunen*: Kitabu-n-nikah, 39-Babun fi-l-kismi bejne-n-nisai, hadithi nr. 2134; Nesaiu, *Sunen*: 36-Kitabu ‘ashereti-n-nisai, 2-Babu mejli-r-rexhuli ila ba’di nisaihi dune ba’din; Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 47-Babu-l-kismetu bejne-n-nisai, hadithi nr. 1971.

⁷⁹ *Kur’an*: Nisa’ë, 129.

Kështu nganëherë duke ditur për dashurinë më të madhe të Muhamedit s.a.v.s. ndaj Ajshes r.a. disa gra të Muhamedit s.a.v.s. rendin e tyre ia kanë lëshuar Ajshes r.a.⁸⁰

XHELOZIA

Xhelozia është e dëmshme, posaçërisht nëse nuk ka kurrfarë arsye për të. Ajo është e mirëseardhur vetëm nëse ka ndonjë dyshim. Atëherë njeriu duhet të bëhet xheloz, me qëllim që të reagojë në disa sjellje të këqia të gruas. Në hadithin e Xhabir ibn Atikut, i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka theksuar se ka xhelozitë të cilën Allahu e do dhe të cilën nuk e do. All-llahu e do xhelozinë e cila është e bazuar në dyshime.⁸¹

Për fat të keq, shumë burra mbesin memecë dhe të verbër para sjelljeve jomorale të grave të tyre, kështu që shpesh nuk dinë as ku shkojnë, ku qëndrojnë, e as që dinë se me kë komunikojnë e të ngjashme, duke u arsyetuar se nuk janë xhelozë. Përkundrazi, ata janë të obliguar që me xhelozitë të ruajnë dhe të mbrojnë gratë e tyre dhe të vëzhgojnë sjelljet dhe moralin e tyre.

⁸⁰ Shih psh.: Ebu Davudi, *Sunen*: Kitabu-n-nikah, 39-Babun fi-l-kismetit bejne-n-nisai, hadithi nr. 2135.

⁸¹ Ebu Davudi dhe Nesaiu në *Sunene*, Ahmedi në *Musned* dhe Ibn Hibbani në *Sahib*. Albani e vlerëson si transmetim hasen. (Shih: *Sabihu-l-xhami'i-s-sagiri ve zjjadetubu*, hadithi nr. 2221)

Hasan el-Basriu ka tërhequr vëmendjen: “Pse nuk i qani gratë tuaja të cilat shtyhen me rrugaçët nëpër tregje?! Allahu e ka bërë të keq atë i cili nuk është xheloz në këtë!”⁸²

Muhammedi s.a.v.s. në hadithin të cilin e transmeton Ajsheja r.a. thotë: “O Ummeti i Muhamedit, askush nuk është më xheloz se All-llahu kur sheh robin ose robëreshën e Tij duke bërë zina. O Ummeti i Muhamedit, ta dini atë që di unë, pak do të kishit qeshur e më shumë do të kishit qarë!”⁸³

Pra, ky lloj i xhelozisë është i pranueshëm, e mund të thuhet edhe obligim i burrit.

BURRI KA OBLIGIME NDAJ GRUAS

Burri nuk është i obliguar që vetëm materialisht ta mirëmbajë gruan, por është i obliguar që të plotësojë edhe obligimet e martesës. Njëra prej tyre është që në marrëdhëniet intime të kënaqë gruan e tij. Në të vërtetë, në bazë të hadithit të Muhamedit s.a.v.s., kur burri kënaqë nevojën e tij me rastin e marrëdhënieve intime, atëherë është i obliguar që atë kënaqësi t’ia ofrojë edhe gruas së tij.⁸⁴

⁸² Gazaliu, *Ihjan ‘ulum-i-d-din*, 2/141.

⁸³ Buhariu, *Sahib*: 67-Kitabu-n-nikah, 107-Babu-l-gajreti, hadithi nr. 5221.

⁸⁴ Shih për këtë: Mr. M. Štulanović, vep.cit., fq. 33.

Përndryshe, burri nuk ka të drejtë që tërë natën ta kalojë në ibadet, pasi që në të ka të drejtë edhe gruaja e tij. Abdullah ibn Amr ibn Asi r.a. transmeton se e ka pyetur Muhamedi s.a.v.s.: *“Mora vesh se ditët i kalon në agjërim ndërsa netët në ibadete? Ai është përgjigjur: Po! Muhamedi s.a.v.s. e këshilloi: “Mos bën ashtu. Agjëro, por edhe ha. Fahu, por edhe flej! Edhe trupi yt ka të drejtë, sytë e tu kanë të drejtën e tyre ndërsa edhe gruaja jote ka të drejtë ndaj teje!”*⁸⁵

NËSE GRUAJA E HUAJ JU FASCINON, KOMPENSONE KËTË NË GRUAN TUAJ

Nëse ndodhë që mashkullin ta fascinojë ndonjë grua e huaj dhe ai ndjenë ndonjë lloj të tërheqshmërisë ndaj saj, është i obliguar që sa më shpejtë të shkojë te gruaja e tij dhe ta kompensojë me të. Në hadithin të cilin e transmeton Xhabir ibn Abdullahu r.a. i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: *“Nëse ndonjërin prej jush e tërheq ndonjë grua, pastaj në zemrën e tij lind diçka, le t’i afrohet gruas së tij dhe le ta kompensojë atë me të, pasi që ajo do t’ia largojë atë që i ka lindur në zemër!”*⁸⁶

⁸⁵ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 89-Babun li zevxhike ‘alejke hakkun, hadithi nr. 5199.

⁸⁶ Muslimi, *Sabih*: 16-Kitabu-n-nikah, 2-Babu nedbi men rea imre’eten, feveka’at fi nefsihi ila en je’tije imreetehu ev xharijetehu fejuvaki’aha, hadithi nr. 1403; Tirmidhiu në *Suner*. 10-Kitabu-r-reda’a, 9-Babun men xhae fi-r-rexhuli jere-l-me’ete tu’xhibuhu, hadithi nr. 1158 dhe e cilëson si sahih-hasen-garib; Ebu Davudi, *Suner*. 12-Kitabu-n-nikah, 44-Babu ma ju’meru bihi min gaddi-l-besari, hadithi nr. 2151.

KULTURA E SJELLJES SË GRUAS NDAJ BURRIT

Gruaja është e obligueshme ndaj burrit në:

NËNSHTRIM

Allahu i Lartësuar thekson se gruaja duhet t'i nënshtrohet burrit të saj. Ai thotë: “Burrat janë përgjegjës për gratë, ngase All-llahu ka graduar disa mbi disa të tjerët dhe ngase ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre. Prandaj, me atë që All-llahu i bëri të ruajtura, gratë e mira janë shpektuese, janë besnike ndaj së fshehtës.”⁸⁷

Nënshtrimi i gruas ndaj burrit në mënyrën ashtu siç obligon Zoti i botërave, do të rezultojë me harmoni në martesë, ndërsa kundërshtimi do të rezultojë me joharmoni dhe me anarki.

Sa është me rëndësi nënshtrimi i gruas ndaj burrit të saj, më së miri do të ilustron një hadith i Muhamedit s.a.v.s. në transmetimin e Ebu Hurejres r.a.: *“Po t'i kisha urdhëruar dikujt që t'i bëjë sexhde dikujt, do t'i kisha urdhëruar gruas t'i bëjë sexhde burrit të saj!”*⁸⁸

⁸⁷ *Kur'anî*: Nisa'ë, 34

⁸⁸ Tirmidhiu, *Sunen*: 10-Kitabu-r-reda', 10-Babun ma xhae fi fi hakki-z-zevxhi 'ale-l-mer'eti, hadithi nr. 1159 dhe e vlerëson si hasen-garib; Ahmedi, *Musned*, 5/227 dhe 228.

Nëse gruaja tregon dozë të mjaftueshme të nënshtrimit ndaj burrit të saj, Muhamedi s.a.v.s. nëpërmjet transmetimeve të Ebu Hurejres, Enesit r.a. dhe të tjerëve, i premtun hyrjen në Xhennet:

“Nëse gruaja i falë pesë kohët e namazit, agjëron Ramazanin, e ruan moralin e saj dhe i nënshtrohet burrit të saj, do t’i thuhet asaj: hyn në xhennet, nga cilado derë!”⁸⁹

FALËNDERIM

Bashkë me nënshtrimin dhe dëgjueshmërinë ndaj burrit, gruaja duhet të tregojë një falënderim të veçantë ndaj tij në gjithë çka që ai vepron. Ajo nuk guxon të jetë jo falënderuese nëse ai i ndalon ndonjë dëshirë asaj. Për fat të keq, ky është rast i shumë grave. Në këtë tërheq vërejtjen edhe i Dërguari i All-llahut s.a.v.s., në hadithin të cilin e transmetojnë Abdullah ibn Abbasi dhe Imran ibn Husajni r.a:

“Më është paraqitur xhehenemi, dhe pashë se gratë janë banorët më të shumtë, sepse fshehin (mbulojnë) të vërtetën (jekfurne).” Është pyetur: “A fshehin ato besimin në Allahun?” I Dërguari s.a.v.s. është përgjigjur: “Ato fshehin bamirësinë e burrave të tyre. Janë jo falënderuese në

⁸⁹ Ibn Hibbani, *Sahib*; Taberaniu, *El-Mu’xhemu-l-ensatu*, 2/169; Ebu Nu’ajm, *Hil’jetu-l-evlija*, 6/308

Albani e vlerëson si transmetim autentik. (Shih: *Sahibu-l-xhami’i-s-sagiri ve zjjadetubu*, hadithi nr. 660 si dhe në *Adabu-ç-çefafi fi-s-sunneti-l-mutabbereti*, fq. 286)

bamirësi. Po t'i bëni mirë tërë jetën, dhe nëse vërenë te ju diçka jo të këndshme, do të thotë: Nuk kam parë prej teje kurrë të mira!”⁹⁰

Imam Neveviu, jo falënderimin e gruas në të mirat e burrit dhe mohimin e përpjekjeve të tij, e konsideron ndër mëkatet e mëdha, ndërsa Ibn Bettali thotë se në bazë të hadithit të lartëshënuar, personi jo falënderues do të dënohet dhe tërheq vërejtjen se falënderimi ndaj atij i cili bën mirë bie në obligim fetar të ndërsjellë.⁹¹

KUJDESET PËR SHTËPINË DHE FËMIJËT

Një ndër detyrat më me rëndësi të gruas është të kujdeset për shtëpinë e burrit të saj dhe me kujdes të madh të ruajë, edukojë dhe rrisë fëmijët. Në të vërtetë, gruaja përveç që është nënë, ajo është edhe pedagoge, mësuese dhe mjeke në shtëpinë e saj.

Burri për shkak të natyrës së punëve dhe obligimeve të tij, është i obliguar të: furnizojë familjen, ndërsa mungesa e shpeshtë e tij, si dhe përpjekjet e vogla lidhur me lindjen dhe edukimin e drejtëpërdrejtë të fëmijëve, janë larg mundësive që të kontribuojë në edukimin kualitativ ashtu siç mund ta bëjë gruaja. Andaj i Dërguari s.a.v.s. më së miri ka klasifikuar detyrat e çdo anëtari të

⁹⁰ Buhariu, *Sahib*; 67-Kitabu-n-nikah, 88-Babu kufrani-l-‘ashiri, hadithi nr. 5197 dhe 5198.

⁹¹ Shih: *Sahibu-l-Buhari*, 1/53.

familjes. Ai ato detyra dhe obligime i ka krahasuar me bariun dhe kopenë. Le të shohim se sa bukur i Dërguari ynë, ka definuar ato obligime, në një hadith të cilin e transmeton Abdullah b. Omer r.a.:

“Të gjithë ju jeni barinj dhe secili prej jush do të përgjigjet për kopenë e tij. Udhëheqësi është bari.”⁹² Burri është bari në familjen e tij, derisa gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit të saj dhe të fëmijëve të saj. Domethënë, të gjithë ju jeni barinj dhe të gjithë jeni përgjegjës për kopetë e juaja.⁹³

⁹² Udhëheqësi dhe strukturat udhëheqëse në islam konsiderohen barinj dhe shërbëtor që duhet t'i shërbejnë popullit të tij dhe të përdorin të gjitha mekanizmat që jeta e qytetarëve të tij të jetë sa më e mirë dhe ngritja e tyre shpirtërore sa ma kualitative. Udhëheqësi, sipas Islamit, nuk udhëheqë me njerëzit. Ai angazhohet që ligji i All-llahut të udhëheqë me njerëzit, e ai është më përgjegjësi që përpiqet që ligji i All-llahut të mbizotëroj ndaj njerëzve. Ai, në kuptimin e drejtë, është bari, që me të gjitha mënyrat e mira të mundëshme nuk lejon që populli i tij të shkoj në rrugë të gabuar, ashtu siq çdo bari e ruan kopenë që mos të hyjë në të huajën dhe të bëjnë dëme.

⁹³ Buhariu, *Sahih*: 67-Kitabu-n-nikah, 90-Babun: el-mer'etu ra'ijjetun fi bejti zevxhiha, hadithi nr. 5200; Muslimi, *Sahih*: 33-Kitabu-l-imate, 5-Babu fadileti-l-imami-l-'adli, hadithi nr. 1829; Ahmed, *Musned*, 2/5, 54 dhe 111.

RUAN MORALIN E SAJ DHE PASURINË E BURRIT KUR AI MUNGON

Gruaja është e obliguar që në mungesë të burrit të saj, të ruajë moralin e saj dhe pasurinë e tij. Muhammedi a.s. në transmetimet e Ebu Hurejres, Ebu Umames dhe Abdullah ibn Selamit r.a. ka theksuar : *“Gruaja më e mirë është ajo e cila të gëzjon kur e shikon, e cila të dëgjon kur diçka e urdhëron dhe e cila e ruan autoritetin tënd, moralin e vet dhe pasurinë tënde kur mungon!”*⁹⁴

⁹⁴ Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 5-Babu efdali-n-nisai, hadithi nr. 1857; Ahmedi, *Musned*: 2/251, 432 dhe 438. Gjithashtu e transmetojnë edhe Nesaiu, Hakimi dhe Taberaniu. Albani e vlerëson si autentik. (Shih: *Sabihu-l-xbami’i-s-sagiri ve zjjadetibi*, hadithi nr. 3298 dhe 3299)

NUK DO TË AGJËROJË PA LEJEN E BURRIT

Se sa islami i kushton rëndësi harmonisë së jetës bashkëshortore, më së miri tregon hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejre, në të cilin Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: *“Gruas nuk i është lejuar të agjërojë, në prezencën e burrit të saj, pa lejen e tij!”*⁹⁵

Kuptohet, këtu qëllimi është në agjërimin nafile (vullnetar) e jo atë të obligueshëm gjatë muajit të Ramazanit. Ky hadith, në formë eksplicite tregon se sa islami përkujdeset në ruajtjen, ngritjen dhe forcimin e dashurisë ndërmjet bashkëshortëve. Sepse, me agjërim gruaja mund të humb eventualisht në fuqi dhe në freskinë e saj, dhe me rastin e afrimit të burri i saj, ndoshta nuk do të mund të tregojë dëshirë të mjaftueshme për atë çka ai dëshiron. Apo ndoshta, burri ndjenë nevojë për gruan gjatë ditës, e nëse ajo është agjërueshëm, atëherë do të jetë i penguar nga kjo dëshirë (për kontakt), ashtu siç transmetohet nga Ebu Se'id el-Hudriut r.a. në të cilin gruaja e Safvanit r.a. i është ankuar Muhamedit s.a.v.s. se nuk po i lejon agjërimin nafile, dhe Safvani r.a. në pyetjen e Muhamedit s.a.v.s. ka thënë: *“Ajo agjëron e unë jam i ri dhe nuk mund të duroj (për t’iu afruar). Atëherë Muhamedi s.a.v.s. tha: “Gruaja nuk do të agjërojë pa lejen e burrit!”*⁹⁶

⁹⁵ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 86-Babun la te'dhenu-l-mer'etu fi bejti zevxhiha li ehadin il-la bi'idhnihi, hadithi nr. 5195; Muslimi, *Sabih*: 12-Kitabu-z-zekat, 26-Babun ma enfeka-l-'abdu min mali mevlah, hadithi nr. 1026.

⁹⁶ Ebu Davudi, *Sunen*: Kitabu-s-savmi, Babu-l-mer'eti tesumu bigajri idhni zevxhiha, hadithi nr. 2459; Ahmedi, *Musned*, 3/80.

Gruas i lejohet agjërimi nafië kur burri i saj mungon, gjegjësisht është në udhëtim. Mirëpo, nëse ai kthehet nga udhëtimi dhe dëshiron t'i afrohet gruas së tij, ajo mund të prishë agjërimin, sepse plotësimi i dëshirës së burrit është obligim ndërsa agjërimi jashtë Ramazanit është nafië.⁹⁷

Shikoni se si në këto hadithe shihet urtia e pafund e islamit, i cili jo vetëm që ruan marrëdhëniet martesore, por nxitë, forcon dhe stabilizon ato.

NUK E LËSHON ASKEND NË SHTËPI PA LEJEN E BURRIT

Gruaja nuk e lëshon të hyjë në shtëpi askë pa lejen e burrit, posaçërisht kjo ndalesë ka të bëjë për personat të cilët nuk janë në afri me të (mahrem). I Dërguari i Allahut s.a.v.s. qartë e ka theksuar këtë në vazhdimin e hadithit të mëparshëm në të cilin thotë se gruas përveç agjërimit vullnetar: *“I ndalohet që të lëshojë në shtëpi dikë pa lejen e burrit!”*⁹⁸

Kuptohet, me këtë islami godet të keqen mu në rrënjë. Sepse, nëse ndonjë mashkull hyn në shtëpinë e gruas me të cilën nuk është në lidhje familjare, posaçërisht nëse vetmohet me të, mund

Hadithi është i besueshëm (Shih: Shejh Halid ‘Abdurrahman el-‘Akk, *Vaxhibatu-l-mer’eti-l-muslimë*, fq. 90)

⁹⁷ Shih për këtë konstatim tek Ibn Haxheri, *Fet’hu-l-Bari*, 9/207.

⁹⁸ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 86-Babun la te’dhenu-l-mer’etu fi beji zevxhiha li ehadin il-la bi’idhnihi; Muslimi, *Sabih*: 12-Kitabu-z-zekat, 26-Babun ma enfeka-l-‘abdu min mali mevlah.

të vijë deri te pasojat e paparashikueshme, amoraliteti ose më së paku deri të dyshimi. Shumë hadithe të Muhamedit s.a.v.s. ndalojnë këtë praktikë dhe rreptë e gryojnë.

Kështu, në transmetimin e Xhabirit r.a. i Dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë: “Mos hyni te gratë kur u mungojnë burrat, sepse shejtani ecë nëpër ju ashtu siç ecë gjaku në venët e juaja!”⁹⁹

Ibn Abbasi r.a. transmeton se e ka dëgjuar të Muhamedin s.a.v.s. si thotë: “Mos të vetmohet një burrë me një grua tjetër pa prezencën e mahremit të saj!”¹⁰⁰

I dërguari i Allahut s.a.v.s. posaçërisht ka tërhequr vërejtjen në vetmimin e gruas me të afërmit e burrit, që mund të shkaktojë pasoja edhe më të mëdha sesa vetmimi me ndonjë të huaj. Ukbe ibn Amir r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka tërhequr vërejtjen: “*Ruajuni vetmimit me gratë (të cilat nuk janë afri familjare me ju)!*” Në këtë një ensar ka pyetur: “*E çka thua për hamv (kuntin)?*” Muhamedi s.a.v.s. është përgjigjur: “*Ai është sikur vdekja!*”¹⁰¹

⁹⁹ Tirmidhiu, *Sunen*: 10-Kitabu-r-reda’a, 17-Bab, hadithi nr. 1172 dhe e vlerëson si transmetim garib.

¹⁰⁰ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 111-Babun ma jahluvenne rexlulun bi imre’etin il-la dhu mahremin ve-d-duhulu ‘ale-l-mugibe, hadithi nr. 5233; Muslimi, *Sabih*: 15-Kitabu-l-haxhixh, 74-Babu seferi-l-mer’eti me’a mahremin ila haxhixhin ve gajruhu, hadithi nr. 1341.

¹⁰¹ Buhariu, *Sabih*: 67-Kitabu-n-nikah, 111-Babun ma jahluvenne rexlulun bi imre’etin il-la dhu mahremin ve-d-duhulu ‘ale-l-mugibe, hadithi nr. 5232; Muslimi, *Sabih*: 39-Kitabu-s-selam, 8-Babu tahriri-l-halveti bi-l-exhnebijeti ve-d-duhuli ‘alejha, hadithi nr. 2172.

El Hamm, sipas disave do të thotë vëllai i burrit, ndërsa sipas linguistëve, siç përmend Imam Neveviu, tregon ndonjë të afërm të ngushtë të familjes siç janë: babai, xhaxhai, vëllai, kusheriri etj.¹⁰²

Muhamed Fuad Abdul-l-Baki, duke komentuar këtë hadith thotë se nuk është rrezik për gruan nga familja e burrit siç janë babai ose djemtë e burrit, të cilët bëhen mahremë të saj dhe atyre u është e lejuar vetmimi me të, por rrezik i vërtetë paraqesin vëllai i burrit, domethënë kunati pastaj kusheriri i burrit, xhaxhai etj të cilët nuk mund të vetmohen me gruan dhe nuk bijnë në mahrem të gruas. Rreziku i madh qëndron në atë se ata janë të afërmit e burrit, kanë mundësi më të mëdha të gjenden në situatë të jenë të vetmuar me gruan e vëllait të tij ose familjarit të tyre dhe kjo situatë nuk i nxitë të tjerët në dyshime, ashtu siç do të mund të ndodhte me ndonjë të huaj, i cili nuk është në marrëdhënie familjare me burrin.¹⁰³

Për fat të keq, kjo praktikë e vetmimit të ne është e zakonshme, dhe në bazë të vërejtjeve të Muhamedit s.a.v.s. duhet ndërprerë këtë praktikë. Personat të cilët në bazë të njohjes së rregullave islame, i janë përmbajtur udhëzimeve të Muhamedit s.a.v.s., kanë qenë të përqeshur dhe janë quajtur ekstrem. Mirëpo, vetëm pasimi i drejtëm i këshillave të Muhamedit s.a.v.s. mund të rezultojë me harmoni në martesë dhe preventivë nga veprimet amorale dhe situatave të kurvërisë.

¹⁰² Krahaso: *Fet’hu-l-bari*, 9/242-243.

¹⁰³ Shih komentin e Muhammed Fuad Abdu-l-Baki në *Sabihu-l-Muslim*, 4/1711. (Botimi i Daru-l-Hadith, Kajro 1991)

NUK E SHQETËSON BURRIN

Gruaja duhet të mundohet që të mos e shqetësojë dhe maltretojë burrin e saj. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. këtë e ka theksuar në një hadith të cilin e transmeton Mu'adh b. Xhebel r.a.: *“Asnjë grua nuk do ta shqetësojë burrin e saj në këtë dunja e hyrja e Xhennetit të mos thotë: Mos e shqetëso, Allahu të vraftë! Ai të ti është vetëm shkurt ndërsa së shpejti do të të lërë dhe do të vijë tek ne!”*¹⁰⁴

NUK E REFUZON

Gruaja do të ketë kujdes që të mos refuzojë burrin e saj kur e thërret në plotësimin e nevojave të tij. Ebu Hurejre r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka tërhequr vërejtjen: *“Nëse një burrë e thërret gruan e tij në shtrat, dhe ajo e refuzon, ndërsa ai fle i hidhëruar në të, atë grua do ta mallkojnë melaiket deri në agim!”*¹⁰⁵

¹⁰⁴ Tirmidhiu, *Sunen*: 10-Kitabu-r-reda'a, 19-bab, hadithi nr. 1174 dhe e vlerëson si hasen-garib; Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 62-Babun fi-l-mer'eti tu'dhi zevxheha, hadithi nr. 2014; Ahmedi, *Musned*, 5/242 me zingjir transmetuesish të fortë.

¹⁰⁵ Buhariu, *Sahib*: 67-Kitabu-n-nikah, 85-Babun idha bateti-l-mer'etu muhaxhireten firashe zevxhija, hadithi nr. 5193; Muslimi, *Sahib*: 16-Kitabu-n-nikah, 20-Babu tahrimi imtina'iha min firashi zevxhiha, hadithi nr. 1436.

Në dy përmbledhjet (Buhari dhe Muslimi) thuhet se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Nëse gruaja fle jashtë shtratit të burrit të saj, melaiket do ta mallkojnë deri në agim! Dhe pasha Atë, në dorën e të cilit është shpirti im, çdo burrë që e thërret gruan e tij në shtrat dhe ajo e refuzon, i hidhëruar në të është Ai i cili është në qiell, derisa burri nuk qetësohet!”¹⁰⁶

NUK E REFUZON, QOFTË DUKE E LËNË EDHE BUKËN TË DIGJET

Nëse burri kërkon t’i plotësojë nevojat e tij intime, gruaja duhet t’ia plotësojë qoftë edhe nëse e ka bukën në zjarr. Kjo bazohet në hadithin të cilin Talk ibn Ali e transmeton nga Muhamedi s.a.v.s.: “Nëse burri e thërret gruan e tij që të kënaqë nevojat e tij, le t’i shkojë, qoftë edhe nëse e ka bukën në furrë!”¹⁰⁷

El Mubarekfuri duke e komentuar këtë hadith, thotë se gruaja është e obliguar që të kënaqë burrin e saj, qoftë edhe nëse e ka futur bukën në furrë, duke e ditur se nuk guxon të largohet nga furra, me qëllim që buka mos të digjet. Më mirë është që buka të digjet sesa burri të humb durimin dhe të shkojë në amoralitet.¹⁰⁸

¹⁰⁶ Po aty.

¹⁰⁷ Tirmidhiu, *Sunen*: 10-Kitabu-r-reda’a, 10-Babun ma xhae fi hakki-z-zevxhi ‘ale-l-mer’eti, hadithi nr. 1160 dhe e vlerëson si hasen-garib.

¹⁰⁸ Shih: *Tuhfetu-l-ahvedhi*, 4/324-325

KUSHTI PËR XHENNET ËSHTË KËNAQJA E BURRIT

Se sa janë me rëndësi marrëdhëniet e mira mes burrit dhe gruas më së miri tregon hadithi i Ummi Selemes r.a. në të cilin i Dërguari i Allahut s.a.v.s. kushtëzon hyrjen në Xhennet të gruas me kënaqjen e burrit. Ai thotë: *“Secila grua e cila vdes, ndërsa burri i saj është i kënaqur me të, do të hyjë në Xhennet!”*¹⁰⁹

NUK KA DËGJUESHMËRI NDAJ BURRIT NË MËKAT

Gruaja është e obliguar t'i nënshtrohet burrit në gjithçka që nuk bie ndesh me mësimet e islamit. Nëse vie deri te kundërshtimi i ndonjë rregulli islam, atëherë gruaja nuk do të dëgjojë burrin e saj. Imam Buhariu një kaptinë e ka pagëzuar: *Gruaja nuk do t'i nënshtrohet burrit në mëkate*. Në atë kaptinë, ai thekson një hadith të Ajshes r.a. që thotë se një ensare ka martuar vajzën e saj, të cilës i kishin rënë flokët. Burri i kishte urdhëruar që të vendosë flokë të huaja (parukë), dhe me këtë rast

¹⁰⁹ Tirmidhiu, *Sunen*: 10-Kitabu-r-reda'a, 10-Babun ma xhae fi hakki-z-zevxi 'ale-l-mer'eti, hadithi nr. 1160 dhe e vlerëson si hasen-garib; Ibn Maxhe, *Sunen*: 9-Kitabu-n-nikah, 4-Babu hakki-z-zevxi 'ale-l-mer'eti, hadithi nr. 1854.

Muhamedi s.a.v.s. këtë e ka ndaluar duke thënë: *“Jo! Janë të mallkuar ata të cilët fusin flokët e buaja në flokët e tyre!”*¹¹⁰

MARTESA SI MBUROJË NDAJ ANARKISË MORALE

Devijimet bashkëkohore morale kanë marrë hov të madh edhe tek ne edhe në botë. Mediumet, detyrë e të cilëve është të ruajnë moralin dhe pengojnë erozionin e tij, vetë kontribuojnë për shkatërrim, tejkalimin e kufijve moral dhe nxisin anarki morale.

Në planin e jetës seksuale, perëndimi moti kohë është duke shkuar drejt humnerës. Në të vërtetë, intelektualët e saj qartë tërheqin vërejtjen në këtë rrezik. Kështu, sociologu i njohur Will Durant, në librin e tij *Magjia e filozofisë* tërheq vërejtjen: *“Jeta në qytetet e civilizuar nuk i lejon njeriut që aspak të mendojë për martesë, derisa eposhet seksuale janë në rritje, ndërsa kushtet mundësojnë kënaqësitë. Kështu, pastërtia, e cila më herët është konsideruar virtyt, sot ajo është bërë mjet përqeshjeje dhe nënçmimi. Në këtë atmosferë humb edhe turpi, i cili më herët ka zbuluar njeriun, ndërsa gratë nën velon e barazisë me meshkujt, hyjnë në lidhje të pakufishme jashtëmartesore dhe kejo bëhet diçka e zëkonshme. Sot ka më pak prostitute nëpër rrugë, jo për shkak të policisë, por për shkak se kanë humbur punën duke iu falënderuar grave të cilat këtë e bëjnë pa para.”*¹¹¹

¹¹⁰ Buhariu, *Sahib*: 67-Kitabu-n-nikah, 94-Babun la tuti’u-l-mer’etu zevxheha fi ma’sijetin, hadithi nr. 5205.

¹¹¹ Sejid Musava Lari, *Islami dhe civilizimi perëndimor*, fq. 31-32.

Teoria e Frojdit e cila të gjitha aktivitetet njerëzore i shpjegon nëpërmjet ndjenjave seksuale, shumë veta i ka çuar në shkatërrimin më të madh seksual. Kjo teori seksin e ka ndarë prej moralit. Ndershmëria ka eroduar në fundin e pakufishëm. Le të shikojmë disa të dhëna:

Psikologu Dale Carnegie thotë: “Të dhënat statistikore të cilat i ka publikuar një fondacion amerikan, tregojnë se burrat për të cilët dihet se kanë tradhëtuar gratë e tyre, i takojnë të gjitha klasave sociale dhe moshave. 50% të anketuarve nganjëherë kanë tradhëtuar gratë, ndërsa disa prej tyre përherë. Pjesa tjetër, ata të cilët janë besnikë ndaj gravë të tyre, kanë mbetur besnik ose për shkak të ndonjë frike, sëmundje, skandali apo për shkak se nuk kanë pasur mundësi të tradhëtojnë. Përgjimi i telefonave në Nju Jork për një interval të shkurtë kohor, ka shpalosur se shumë gra të Nju Jorkut gjithashtu kanë tradhëtuar burrat e tyre.”¹¹²

Është interesant e dhëna se prej numrit të përgjithshëm të spitaleve amerikane, 650 prej tyre janë të specializuara për sëmundje venerike (seksuale)! Numri i fëmijëve të lindur jashtëmartesor në Amerikë është në rritje e sipër, e cila i shkakton probleme të mëdha qeverisë së këtij shteti. Statistikat e vitit 1957 tregojnë për më shumë se 200.000 fëmijë të lindur jashtë martese, ndërsa ky numër rritet 5 përqind për çdo vjet brenda 20 vjetëve.

Vetëm në Amerikë për çdo vit numri i aborteve arrinë 1.000.000 raste! Prej tyre, 65 përqind janë pasojë e marrëdhënieve jashtëmartesore, ndërsa tjerat janë nga vajza dhe gra të liral!

Gjendje aspak më e mirë nuk është edhe në vendet tjera të perëndimit. Kështu, dr. Molenz nga Londra thotë: “Çdo e pesta vajzë e pamartuar e cila shkon në kishë në Angli, është me barrë.

¹¹² Po aty, 32-33.

Numri i aborteve vetëm në Londër arrinë shifrën prej 50.000 për një vit! Më së shumti fëmijë jashtëmartesor lindin në familje me ekonomi stabile, ndërsa vajzat e familjeve të pasura më shumë preferojnë të bëhen nëna të pamartuara!”¹¹³

Si dhe me çfarë shpejtësie Evropa është duke shkuar në ambis pa fund, më së mirë do të ilustrojë e dhëna e gazetës *Oslobodenje*: “Në korrik të vitit 1997 në Berlin janë tubuar më shumë se një milion të rinjë në paradën (defilenë) tradicionale të dashurisë. Bëhet fjalë për një festival të hapur në të cilin takohen grupet tekno, dance dhe hip-hop me ithtarët e tyre. Kolona e të rinjëve, duke vallëzuar gjysëm të lakuriquar dhe të disponuar për dashuri, arrinte gjatësinë 6 kilometra, kështu që kanë bllokuar tetë drejtime kryesore të rrugëve në këtë qytet!”¹¹⁴

EPIDEMIA E AMORALITETIT KA PËRFSHIRË EDHE QENIEN TONË

Ne nuk do të kishim tepruar ne alarmim, po të mos na kishte përfshirë kjo epidemi edhe ne. Mirëpo, për fat të keq, kjo sëmundje na ka përfshirë dhe po zgjerohet edhe më shumë, kështu që kërkon aksion të shpejtë dhe energjik të të gjithë faktorëve relevant të popullit tonë, me qëllim të ndërprerjes ose të zvogëlimit të kësaj epidemie të madhe.

¹¹³ Po aty, 33.

¹¹⁴ *Oslobodenje*, 13.07.1997, nr. 17640

Amoraliteti i përmasave të gjëra është kryesisht pasojë e luftës dhe agresionit ndaj vendit tonë. Numër i madh i grave gjatë kohë ka qenë në shpërngulje, të ndara nga burrat legalë, ndërsa një numër tjetër kanë mbetur përgjithmonë pa burra të cilët kanë rënë duke e mbrojtur atdheun e vet.

KUSH ËSHTË FAJTOR?!

Athua vetëm gratë janë fajtori kryesor dhe i vetëm i kësaj anarkie morale? Menjëherë duhet konstatuar se një numër të madh të fajit bartin edhe ato. Mirëpo, jo vetëm ato. Fajtorë ka shumë! Në të vërtetë, fajtor dhe bashkëfajtor është edhe ai i cili ka mënyra për të ndërprerë këtë epidemi dhe këtë vërshimë të amoralitetit, e ai nuk ndërmerr asgjë. Fajtor janë edhe ata të cilët vetëm materialisht i ndihmojnë ndërsa nuk u bie ndërmend aspak që të shikojnë nevojat e tyre natyrore dhe epshin e tyre seksual, të grave të reja të cilat kanë mbetur pa burra. Fajtor janë edhe ata të cilët gjithë këtë e shikojnë me ndërgjegje të qetë, duke harruar se jemi në një anije të njëjtë dhe se padyshim se jemi duke u fundosur, në bazë të kërcënimit të Allahut!

Është e çuditshme se muslimanët dhe shoqëria në përgjithësi në mënyrë indolente shikojnë problemin në fjalë! Gati se as që gjykohej, e lëre më t'i afrohet problemit në rrënjë për zgjidhjen e tij, nga shkatërrimi ynë përbrenda.

Zotërinj përgjegjës, pa marrë parasysh se në cilat funksione jeni, ju të cilët mund të ndaloni këtë kataklizmë, ju thërras që të lëvizni dhe të ndërmirri hapa konkrete dhe kështu të ndërpreni praktikën e shkatërrimit tonë! Historia na mëson se civilizimet më të mëdha dhe më të fuqishme,

madje edhe shtetet, kanë rënë - jo duke iu falënderuar fuqisë së armiqve të tyre, por anarkisë morale në radhët e tyre. Nuk duhet të harrojmë se shkatërrimi i vlerave morale lind probleme të reja, sëmundje të reja dhe u hapë dyert perverzioneve të reja!

Allahu i Lartmadhëruar këtë e ka paralajmëruar në ajetet e Librit të Tij të Shenjtë. Muhamedi s.a.v.s. gjithashtu nëpërmjet shumë haditheve ka tërhequr vërejtjen se një prej parashenjave të ditës së Gjykimit do të jetë përhapja e kurvërisë!¹¹⁵

ZGJIDHJA ISLAME E KËTIJ PROBLEMI

Mekanizmat të cilat Islami i ka vendosur në largimin prej amoralitetit janë shumë të përsosura. Islami aspak nuk flet për amoralitetin, të cilit gati se është e pamundshme t'i ikësh, kur të gjitha mundësitë për kryerjen e saj i janë afruar njeriut. Islami, në të vërtetë prenë çdo çrregullim që në rrënjë! Për këtë Allahu i Gjithmëshirshëm thotë: *“Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë) sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe.”*¹¹⁶

Me këtë rast është shumë interesant të thuhet se Islami kurrë asnjëherë nuk ndalon diçka e të mos ketë alternativë dhe të mos gjejë zgjidhje se si atë ndalesë të largojë dhe të ruajë nderin e tij. Janë

¹¹⁵ Buhariu dhe Muslimi

¹¹⁶ *Kur'anî: Isra*, 32.

të njohura metodat e veprimit preventiv islam ne planin e çrrënjësjes së prostitucionit dhe çrregullimit moral në shoqëri. Të përkujtojmë disa prej tyre:

Ulja e shikimit dhe largimi nga shikimet e tepruara të personave të gjinisë së kundërt,

Ndalimi i përzjerjes së meshkujve dhe femrave të cilët nuk janë në afri gjaku (familje),

Ndalimi i vetmimit me personat e gjinisë së kundërt pa prezencën e personave tjerë,

Mbulimi i gruas si një masë preventive për ruajtjen e saj dhe afirmimin moral të saj,

Martesa e ligjshme me të cilin ndërpritet shkatërrimi, dhe

Poligamia- martesa me shumë gra që bëhet farz kifaje në rastin e nevojës, kur në një shoqëri ka më shumë femra se sa meshkuj.

POLIGAMIA

MARTESA ME SHUMË GRA

Një numër të vogël të metodave të përmendura ne i përdorim në jetën e përditshme. Medota e fundit e përmendur- martesa poligame- madje përqeshet edhe nga ana e disa ulemave, ndërsa për të tjerët të mos flasim!

All-llahu xh.sh në Kur'an thotë: “Martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tri e me katra...”¹¹⁷

Duke pasë parasysh univerzalitetin e ligjit të Allahut, vërtetoj se kjo është zgjidhja e vetme pas vdekjes së një numri të madh të meshkujve gjatë agresionit në vendin tonë (Bosnjë). Kjo është zgjidhja e vetme edhe për ato vende ku nataliteti i grave është shumë i madh në raport me meshkujt. Të dhënat statistikore tregojnë se p.sh. në Francë numri i femrave është më i madh se i meshkujve për 1.765.000! Në Amerikë ka 20 milion vajza të pamartuara! Profesor Peter Mudalar, nga Univerziteti i Londrës, thotë se numri i femrave në raport me atë të meshkujve është në rritje konstante!¹¹⁸

Të përkujtojmë se një milion gra kanë mbetur të veja në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Në Gjermani ato kanë formuar asociacionin nëpërmjet së cilës kanë kërkuar nga qeveria gjermane që me ligj t'u mundësohet të martohen për burra të martuar. Për fat të keq, Kisha ishte kundër kësaj dhe kjo tërë Evropën e ka infektuar me amoralitet publik!¹¹⁹

Përndryshe në natyrën e gruas është të dojë shtëpi, burrë dhe fëmijë. Kjo nevojë mundet në mënyrë të drejtë të realizohet vetëm në shoqërinë e cila e përkrahë jetën e mirëfilltë familjare me burrë të ligjshëm. Ndërsa Islami këtë e ka rregulluar në mënyrë shumë të natyrsme!

¹¹⁷ *Kur'an*: Nisa'ë, 3.

¹¹⁸ Shih: Sejid Musava Lari, vep.cit., fq. 146-147.

¹¹⁹ Po aty, fq. 149.

Islami e merr njeriun në realitetin e tij, duke mos mohuar ose injoruar nevojat e tij natyrore. Islami nuk është sistem i kënaqet në zbulim të zbrazët, në elegancën artificiale, në ëndërra për siguri e cila bie ndesh me natyrën e njeriut, realitetin e tij dhe rrethinën në të cilën jeton.

Ai është sistem që kujdeset për etikën e njeriut dhe të shoqërisë duke mos lejuar ndërtimin e realitetit material duke i shkatërruar normat etike.

Këto janë teza të detyrueshme për kuptimin e drejtë të martesës me shumë gra në të cilën thërret Islami dhe të cilin e lejon në rastet e caktuara.

Atëherë, si të zgjidhen problemet në shoqëritë të cilat kanë numër më të madh të femrave se sa të meshkujve? A zgjidhet kjo me ngritjen e supeve, mbylljen e syve para realitetit ose t'i lëshohet stuhisë?!

Ngritja e supeve nuk sjell asgjë. Nuk kontribuojmë asgjë me pritje të pabazë dhe dyfytëshe që problemi të zgjidhet vetvetiu. Është e qartë se diçka duhet të ndërmerret. Nëse jemi të bindur në ekzistimin e ndonjë sistemi për zgjidhjen konstruktive të kësaj anomalie sociale, atëherë me këtë rast gjendemi para tri mundësive, prej të cilave (Allahu e di më së miri), njëra është e saktë:

Që çdo njeri i aftë për martesë të martohet me një grua, ndërsa numri tjetër i grave të kalojnë jetën pa mundësinë e përjetimit të atmosferës martesore.

Që çdo njeri i aftë për martesë, të martohet ligjshëm vetëm me një grua, e të ketë dashnore ose të bëjë kurvëri me një apo me më shumë gra. Në këtë rast, gruaja do të ketë marrëdhënie intime mirëpo nuk do të përjetojë e as që do të shijojë bashkësinë martesore.

Dhe mundësia e tretë është që të gjithë njerëzit e aftë ose një numër i tyre, të martohen me shumë gra (deri në katër) kështu që secila prej tyre do të njihë kënaqësitë e burrit nëpërmjet martesës legale, të ligjshme, e jo sikur shoqe ose dashnore!¹²⁰

Duhet patjetër të theksohet se mundësia e parë është kundërnatyrore. Ky fakt, siç thotë Sejjid Kutubi nuk mund të largohet me tregimet e njerëzve fjalëmbël të cilët thonë se gruas nuk i duhet burrë nëse i nënshtrohet punës dhe fitimit. Edhe burri gjenë punë dhe fitim, mirëpo kjo nuk është e mjaftueshme për baraspeshën psikofizike, por martohet dhe kështu jeton në atmosferë natyrore familjare. Edhe gruaja edhe burri kanë nevojat e njëjta në gjithçka, por edhe në lidhje me këtë çështje, sepse të dytë janë krijuar prej një rrënje. Martesa për të dytë është qetësim. Për këtë Kur’ani flet: *“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë) ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”*¹²¹

Mundësia e dytë është kundër përpjekjeve të pastra Islame, njerëzore dhe kundër grave dhe nderit të saj. Këtë e përkrahin njerëzit që dojnë turbullira me çka rrëzojnë edhe fenë dhe të gjitha vlerat morale.

¹²⁰ Shih: Sejjid Kutub, *Nën mbrojtjen e Kur’anit*, 4/263 dhe dr. Jusuf Kardavi, *Hallalli dhe Harami në Islam*, fq. 262.

¹²¹ *Kur’ani*: Rrumë, 21

Mundësia e tretë është ajo të cilën Islami e ka zgjedhur. Këtë e ka zgjedhur si të lejuar mirëpo të kushtëzuar, për t'u ballafaquar me realitetin në të cilën nuk vlenë ngritja e supeve ose tregimi bosh për padrejtësi dhe degradim të gruas, nëse pranon këtë lloj të martesës!¹²²

Pas konstatimit se Islami ofron zgjidhje të vetme të drejtë për gruan, dr. Jusuf Kardavi, thotë: “Kjo është poligamia të cilën e mohojnë perëndimi i krishterë, duke e llogaritur si të shëmtuar, ndërsa në të njëjtën kohë meshkujve të tyre u lejojnë numër të madh të dashnoreve dhe të shoqeve pa kufizime në numër dhe pa ndërmarrjen e asnjë obligimi ligjor e moral ndaj tyre dhe pasardhësve të cilët vijnë si pasojë e numrit të madh të lidhjeve amorale dhe jobesimtare. Pra, cila prej këtyre dy anëve ka përgjigje më të mirë, rrugë më të besueshme dhe më të drejtë?”¹²³

QËNDRIMI I DISA MENDIMTARËVE PERËNDIMORË LIDHUR ME POLIGAMINË

Është me rëndësi të cekim se disa mendimtarë perëndimorë kanë gjykim objektiv ndaj këtij institucioni islam duke ardhur në përfundim se kjo është nevojë shoqërore.

Kështu, Artur Shopenhauer në librin Disa fjalë për gratë thotë: “Të popujt ku është e lejuar martesë me shumë gra, të gjitha grave u mundësohet që të kenë burrë, fëmijë dhe jetë të vërtetë

¹²² Shih: Sejjid Kutub, vep.cit., 4/265.

¹²³ Dr. Jusuf Kardavi, vep.cit., fq 262.

familjare që u përgjigjet nevojave të saj shpirtërore dhe plotëson instinktin e tyre femëror. Për fat të keq, ligjet kishtarë në Evropë nuk lejojnë martesë të shumta dhe shumë gra i nënshtrohen jetës së vetmisë. Disa vdesin të pakënaqura dhe të nënçmuara, disa i nënshtrohen dëshirave dhe nevojës që të fitojnë për të mbetur gjallë nga amoraliteti, disa veniten nga ndërgjegja jo e pastër dhe zemra e thyer. As unë nuk mund të kuptoj madje as pas të menduarit të gjatë për këtë, se pse burri, gruaja e të cilit është e sëmurë nga ndonjë sëmundje vdekjeprurëse, ose është sterile, e paaftë për të lindur, të mos mund të martohet me gruan e dytë, përkaj të parës. Kjo është çështje të cilës Kisha duhet t'i përgjigjet. Për fat të keq, ajo nuk mundet të përgjigjet. Ligjet e mira janë ato të cilat respektohen, ato ligje të cilat sigurojnë jetë të lumtur, e jo ato ligje të cilat njerëzit u mohojnë lumturinë ose i gjykojnë të bartin barra të panevojshme, të cilat nxisin njerëzit që t'i urrejnë dhe në këtë mënyrë shkojnë në skajin tjetër (ekstremin tjetër), në amoralitet, prostitucion ose në ndonjë lloj tjetër të veseve!”¹²⁴

Zonja Ani Bizant, teozofe, thotë: “Perëndimi pohon se nuk pranon martesën me shumë gra. Mirëpo, burrat e perëndimit kanë gjetur mënyrë që të tejkalojnë ligjin dhe të mbajnë marrëdhënie seksuale me shumë gra edhe atë pa ndonjë përgjegjësi të cilën e kërkon martesë e ligjshme. Me këtë, u mundësohet që të largojnë dashnoret e tepërta kur të duan, duke mos u lënë zgjidhje tjetër por të shkojnë në rrugë dhe t'i nënshtrohet prostitucionit publik dhe masiv. Fati i asaj gruaje është e pakrahasueshme me pozitën e gruas e cila ka hyrë në martesë të ligjshme me shumë gra dhe e cila, edhe pse e ndanë burrin më ndonjë grua tjetër, gëzon përkujdesin e burrit, bëhet nënë, madje edhe kryesore në familje. Kur shikoj natën mijëra gra nëpër rrugët e tona, jam e bindur se perë-

¹²⁴ Sejid Musava Lari, fq. 152.

ndimi duhet të mësojë nga Islami dhe duhet të ndërpresë me kritika ndaj Islamit lidhur me martesën me shumë gra. Islami i mundëson gruas në martesën me shumë gra që të ketë burrë dhe fëmijë në krahun e tij në mënyrë legjitime dhe me gjithë respekt. Ndërsa, kjo është më e mirë, më e lumtur, më e ndershme dhe më me sinqeritet për gruan sesa jeta e pasigurt dhe e rëndë e rrugës. Ato gra janë viktimë e pasioneve të burrave! Ajo bartë fëmijën e tij të paligjshëm, ndërsa ligji as që e mbronë!”¹²⁵

Dr Gustav le Bon shkruan: “Asgjë më shumë nuk është kritikuar në Evropë se tradita e Lindjes, martesë me shumë gra. Evropa në asgjë nuk ka gabuar më shumë se sa në kritika të institucionit të poligamisë në martesë. Është e sigurtë se martesë e ligjshme me shumë gra në Lindje është më e ndershme se sa prostitucioni i fshehtë dhe publik i perëndimit. Legalizimi i martesës poligamiste është më e mirë në çdo aspekt!”¹²⁶

PËRFUNDIMI

Çka të themi pas këtyre argumenteve?! A të lejojmë që jomuslimanët para neve të kuptojnë arsyeshmërinë dhe nevojën e kësaj metode të All-llahut në ruajtjen e vlerave morale të një

¹²⁵ Po aty, fq. 152-153.

¹²⁶ Po aty, fq. 153.

shoqërie?! A pas këtyre dëshmime racionale, pragmatike dhe precize të neglizhojmë mirësinë e Allahut?!

Le të përfundojë ky përfundim në pyetjet e theksuara! Përgjigja është te përgjegjësit! Ndërsa të gjithë jemi përgjegjës!!!

KULTURA E SJELLJES ME RASTIN E SHKURORËZIMIT

Vëmendje të posaçme Islami i kushton martesës dhe marrëdhënieve martesore, duke u kujdesur në ruajtjen dhe mbrojtjen e harmonisë martesore dhe me shumë kujdes dhe takt përpiqet të ruajë bashkësinë martesore nga shkatërrimi. Shkurorëzimi bëhet i lejuar vetëm nëse nuk ka kurrfarë mënyre që harmonia dhe pajtueshmëria martesore të mbesin gjallë. Nëse, eventualisht vjen deri te shkurorëzimi i bashkësisë martesore, islami në mënyrë precize ka rregulluar të gjitha detalet në lidhje me të, me qëllim të ruajtjes së nderit të dy bashkëshortëve.

Më herët theksuam se sipas rregullores islame të sjelljes, gruaja është e obligueshme që pas shkurorëzimit, në intervalin kohor të pritjes të kalojë në shtëpinë e burrit të saj, ndërsa burri është i obliguar që ta mbajë, sikur të jenë edhe mëtej në kurorë, deri sa të zgjasë periudha e pritjes (iddetit). Burri është i obliguar që në mundësitë e tij materiale ta mbajë atë, siç thotë Allahu i Lartësuar në Kur'anin fisnik: *“Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që është ngusht*

nga pasuria, le të japë nga ajo që i ka dhënë Allahu, e Allahu nuk ngarkon askë, vetëm aq sa i ka dhënë; mirëpo pas vështirësisë Allahu sjell çlirim (begati) ”¹²⁷

NËSE JANË ME BARRË, MBESIN TE BURRI DERISA TË LINDIN

Është theksuar se shtatzëna, nëse vjen deri te shkurorezimi, duhet të qëndrojë në shtëpinë e burrit të saj deri sa të lindë, ndërsa burri është i obliguar që në atë periudhë ta mbajë, ashtu siç thotë Allahut i Lartësuar në Kur’an: *“Në qoftë se ato janë shtatzëna, atëherë furnizoni ato derisa të heqin barrën e tyre.”*¹²⁸

¹²⁷ *Kur’ani*: Talak, 7

¹²⁸ *Kur’ani*: Talak, 6

NËSE I JAPIN GJI FËMIJËS, MERITOJNË SHPËRBLIMIN

Nëse gruaja i jep gjë fëmijës, atëherë burri, nëse vjen deri te shkurorezimi, është i obliguar t'i japë asaj një shpërblim të caktuar për këtë akt. Allahu xh.sh. këtë shumë mirë e ka theksuar: *“E nëse ato u japin gjë fëmijëve tuaj, atëherë jepnu atyre shpërblimin që u takon dhe kini mirëkuptim në mes jush ashtu si dubet, e në qoftë se hasni në vështirësi ndër vete, atëherë le të kërkojë për të gjdhënese tjetër.”*¹²⁹

Le të shikojmë se si Allahu i Mëshirshëm dëshiron që me të gjitha mënyrat pritjen me rastin e shkurorezimit, madje edhe pas tij, të shfrytëzohet që ish bashkëshortët t'i kthehen martesës së tyre dhe të përtërijnë bashkësinë martesore. Me dhënien gjë fëmijës, nëna do të jetë shumë më e lidhur për atë fëmijë, ndërsa shansat janë të mëdha që në këtë mënyrë, të lidhet edhe për babanë e atij fëmiju. Shikoni se si Allahu i Urtë i përdorë të gjitha mekanizmat që t'i lidhë bashkëshortët me të gjitha mënyrat, dhe nëse vjen deri te shkurorezimi, u ka mundësuar që nëpërmjet kësaj rregulloreje të sjelljeve islame, t'u japë shansë të veçantë që sërish të afrohen dhe t'i kthehen lidhjes së mëparshme?! Nëse analizojmë këto propozime, do të shohim se gjithçka është drejtuar kah kjo!

Përndryshe, udhëzimi i Allahut është që gjdhënia të zgjasë dy vjet të plota, çka do të thotë se kjo vlenë edhe për gratë e shkurorezuara: *“Nënat, ato që duan ta plotësojnë gjdhënien, janë të obliguara t'u*

¹²⁹ Po aty.

*japin gji fëmijëve të vet dy vjet të plota.*¹³⁰ Allahu i Lartësuar nuk lejon që fëmija të vuajë për shkak të mospajtimeve të prindërve dhe ndarjes së tyre.

DËSHMIMI ME RASTIN E SHKURORËZIMIT OSE KTHIMIT

Burri ka të drejtë, derisa e lëshuara është në periudhën e pritjes (iddetit), që ta kthejë ose ta lërë që të kalojë prita dhe ajo të ndahet prej tij. Nëse lejon që koha e pritjes të kalojë, atëherë duhet të bëjë marrëveshje të re me bashkëshorten e tij.

Me rastin e shkurorëzimit apo kthimit, kërkohet dëshmimi i dy personave të drejtë, me qëllim që të largohet çdo dyshim, sepse mund të ndodhë që njerëzit të dinë për shkurorëzimin, mirëpo nuk dinë për kthimin, dhe kjo mund të çojë në spekulime dhe thashetheme. Nga këtu Allahu Bujar, i Cili di gjithçka që na nevojitet, thotë: *“E kur t’i afrohen ato mbarimit të afatit të tyre, atëherë ose mbani (i ktheni në jetën bashkëshortore) si duhet, ose ndanu prej tyre si është e udhës, e këtë do ta dëshmojnë dy dëshmitarë të drejtë nga mesi juaj dhe dëshminë zbatoheni për hirë të Allahut. Kështu këshillohet ai që i beson Allahut dhe Ditës së Fundit, e kush iu përmbahet dispozitave të Allahut, atij Ai i hapë rrugë”*¹³¹

¹³⁰ *Kur’ani*: Bekare, 233.

¹³¹ *Kur’ani*: Talak, 2.

GRAVE NUK DUHET NDALUAR KTHIMIN E SËRISHËM PËR BURRAT E TYRE

Nëse kalon koha e pritjes dhe vjen deri te shkurorëzimi, ndërsa në mesin e ish bashkëshortëve sërish lind dashuria dhe dëshira që sërish të themelojnë bashkësinë martesore, ata kanë të drejtë në këtë dhe të tjerët nuk duhet penguar këtë.

Imam Buhariu thekson nga Hasan El-Basriu r.a, i cili transmeton se Ma'kal ibn Jesar r.a. ka martuar motrën e tij për një ensar gjatë kohës së Muhamedit s.a.v.s., mirëpo ajo martesë rezultoi pas një kohe me shkurorëzim. Kur kaloi afati i pritjes, ish burri i saj sërish ndjeu dëshirë për të por edhe ajo për të, dhe sërish e kërkoi për grua. Mirëpo, vëllai i saj Ma'kal ka refuzuar që ta japë për ish burrin e saj, dhe me këtë rast Allahu i Lartësuar ka shpallur: *“Dhe kur i lëshoni gratë, e ato e përmbushin afatin e tyre (të pritjes) nëse pëlqejnë mes vete ashtu si kërkojnë rregullat, mos i pengoni që të martohen për burrat e tyre. Me këtë këshillohet ai që prej jush e beson Allahun dhe botën tjetër, kjo është më e dobishme për ju, më e pastër, se Allahu e di, e ju nuk e dini.”*¹³² Kur këtë e dëgjoji Ma'kali r.a. pasi që Muhamedi s.a.v.s. ia këndoi këtë ajet, ftoi ensariun dhe sërish e martoi motrën e tij!¹³³

¹³² *Kur'ani*: Bekare, 232.

¹³³ Buhariu, *Sahib*: 68-Kitabu-t-talak, 44-Babun “ve bu’uletuhunne ehakku bi reddihinne” fi-l-‘ideti, hadithi nr. 5331.

SA SHKURORËZIME LEJOHEN ME PERSONIN E NJËJTË?

Shkurorezi, pas të cilit mundet sërish të fillojë jeta e përbashkët, mund të jetë vetëm dy herë. Për këtë ekziston teksti i qartë kur'anor: *“Lëshimi (pas së cilit mund të bëhet rikthimi) është dy herë, e (pastaj) ose jetë e njerëzishme (bashkëshortore) ose shkurorezi me mirëkuptim.”*¹³⁴

ÇKA NËSE VJEN DERI TE SHKURORËZIMI I TRETË?

Theksohet se shkakuar kryesor i kufizimit të shkurorezi me personin e njëjtë ka qenë për shkak se shkurorezi para Islamit nuk ka qenë i kufizuar. Burri ka pasë të drejtë që ta lëshojë gruan, dhe sërish ta kthejë dhe këtë e ka bërë aq herë sa ka dashur.¹³⁵

Allahu i Lartësuar shkurorezin e kufizon në dy herë, sepse i pari është pasojë ndoshta e aktit jo mirë të menduar mes bashkëshortëve, i dyti është testi i fundit për jetë të përbashkët ndërsa shkurorezi i tretë tregon se ajo martesë nuk është në rregull dhe nuk ka mundësi të vazhdimit.

¹³⁴ *Kur'an*: Bekare, 229.

¹³⁵ Shih: Sejjid Kutub, vep.cit., 2/217 dhe Halid ‘Abdurrahman el-‘Akk, *Adabu-l-hajati-ç-çevxhije fi dav’i-l-kitabi ve-s-sunneti*, fq. 377.

Nëse vjen edhe te shkurorëzimi i tretë, atëherë burri nuk mundet ta kthejë bashkëshorten deri sa ajo të mos martohet për dikë tjetër, dhe nëse ai vdes ose vjen deri te shkurorëzimi me të, është e mundur atëherë që sërish të martohet për ish burrin e saj. Allahu Bujar në këtë çështje është shumë i qartë, kur thotë: *“E në qoftë se ai (burri) e lëshon atë (për herë të tretë), pas atij (lëshimi) nuk i lejohet më derisa të martohet ajo për një burrë tjetër. E nëse ai (burri i dytë) e lëshon atë, atëherë për ata të dy, po qe se mendojnë se do t’i zbatojnë dispozitat e Allahut, nuk ka pengesë të riktheben (në bashkëshortësi).”*¹³⁶

Këtu sërish vjen në shprehje urtia e Allahut. Me këtë rregullore burri i cili aq lehtë shkurorëzon gruan e tij bëhet serioz. Nëse nuk vie deri te ky ndryshim rigoroz, e ajo është që ish gruaja e tij të martohet për tjetër, atëherë ai tërë jetën do të shkurorëzohet dhe nuk do të ndalet kurrë.

Nga ana tjetër, nuk mundet që gruaja të martohet për tjetër, e pastaj pa marrëdhënie intime, të shkurorëzohet nga ai me qëllim që t’i kthehet burrit të parë. Jo! Kështu nuk mundet! Ajo duhet të ketë marrëdhënie intime me burrin e ri, e më pas të shkurorëzohet dhe t’i kthehet burrit të parë, me qëllim që ai të përjetojë leksionin e lojës me martesë (kurore).

Ajsheja r.a. transmeton se Rifa’a el-Kuredhi, r.a. është martuar, e gruaja e tij pas shkurorëzimit është martuar për tjetër. Pas një kohe të shkurtër ajo erdhi te Muhamedi s.a.v.s. dhe i është ankuar se burri i ri nuk po i afrohet dhe se organi gjenital i është sikur pëlhurë. Muhamedi s.a.v.s. e ka kuptuar se ajo është bërë pishman dhe dëshiron që sërish t’i kthehet Rifa’iut, dhe i tha se i është e

¹³⁶ *Kur’ani*: Bekare, 230

ndaluar shkurorëzimi me burrin e ri derisa ajo të mos e shijojë organin e tij dhe ai të sajën, domethënë deri sa të vijë te marrëdhëniet intime!¹³⁷

BURRI NUK DUHET TË KËRKOJË T'I KTHEHET DHURATA E KURORËS

Nëse vie deri te shkurorëzimi, burri nuk duhet të kërkojë dhuratën e kurorës mbrapa (mehrën), të cilën ia ka dhënë gruas me rastin e kurorëzimit. Gjithashtu, ai prej saj nuk duhet të kërkojë asgjë që ka harxhuar në mirëmbajtjen e saj gjatë martesës. Allahu i Lartësuar ka thënë: *‘E juve (burrave) nuk u lejohet t’u merrni asnjë send nga ajo që u keni dhuruar (si niqah)...’*¹³⁸

¹³⁷ Buhariu, *Sahih*: 68-Kitabu-t-talak, 37-Babun idha tal-lekaha thelathen thumme tezevexhet ba’de-l-‘iddeti zevxhen gajrehu felem jemmusseha, hadithi nr. 5317.

¹³⁸ *Kur’anî*: Bekare, 229.

GRUAJA DO TË KTHEJË DHURATËN E KURORËS NËSE AJO KA KËRKUAR SHKURORËZIMIN

Nëse ndodhë që gruaja të mos e durojë burrin, të mos ndjejë aspak dashuri ndaj tij, ose madje ndjenë urrejtje të madhe ndaj tij, ndërsa ai me asgjë nuk e ka nxitur në këto sjellje të saj, dhe ajo kërkon shkuroreëzim, atëherë është e obliguar që t'ia kthejë dhuratën e kurorës burrit të saj, me qëllim që të ruhet prej mëkateve, ashtu siç urdhëron Kur'ani: *‘E nëse keni frikë se ata të dy nuk do të mund t'i ruajnë dispozitat e Allahut, atëherë për atë, me çka ajo bën kompensim, për ata të dy nuk ka mëkate.*¹³⁹

Abdullah ibn Abbasi r.a. transmeton se Habiba, vajza e Sehl el-Ensariut r.a. e cila ka qenë e martuar për Thabit ibn Kajsín, ka ardhur te Muhamedi s.a.v.s. dhe ka kërkuar që të shkuroreëzohet nga burri. I ka thënë se nuk i pëlqen aspak, se është i keq dhe se nuk mund të vazhdojë martesën me të. Muhamedi s.a.v.s. ka pyetur se a do t'ia kthente kopshtin të cilën ia ka dhënë si dhuratë kurore, të cilën e pranoi me dëshirë, ia ktheu kopshtin dhe ai i shkuroreëzoi!¹⁴⁰

¹³⁹ Po aty.

¹⁴⁰ Buhariu, *Sabihî*: 68-Kitabu-t-talak, 12-Babu-l-hul'i ve keffe-t-talaku fihi, hadithi nr. 5273, 5275 dhe 5276; Nesaiu, *Sunen*: 27-Kitabu-t-talak, 34-Babu ma xhae fi-l-hul'i; Ebu Davudi, *Sunen*: 13-Kitabu-t-talak, 18-Babun fi-l-hul'i, hadithi nr. 2227

LËSHIMI I GRUAS PARA SE TË KEMI MARRËDHËNIE INTIME ME TË

Nëse vie deri te shkurorëzimi pas fejesës dhe para hyrjes në marrëdhënie intime, burri do t'i japë gjysmën e dhuratës së kurorës. Kjo është kështu për shkak se kjo do të jetë një goditje për gruan, dhe kjo dhuratë e burrit do të ndikojë pozitivisht në psikën e gruas. Allahu për këtë thotë: *“Nuk është mëkat për ju nëse i lëshoni gratë pa pasur kontakt (martesë) me to dhe para se t'u caktoni atyre ndonjë caktim (kurorë-nikah), po pajisni ato (me ndonjë pajisje), pasaniku sipas mundësisë së tij dhe i varfëri sipas mundësisë së tij. Një pajisje e zakonshme është obligim për bëmiresit. E nëse i lëshoni ato para se të kontaktoni, por u keni pas caktuar atyre një caktim (kurorës) atëherë duhet t'u jepni gjysmën e asaj që e keni caktuar, përveç nëse ato ju falin ose ju falë ai në duart e të cilit është lidhja e kurorës. E të falni (burra ose gra) është më afër devotshmërisë, e mos harroni bamirësinë ndërmjet jush. Vërtet, Allahu sheh atë që vepron.”*¹⁴¹

BASHKËSHORTËT LE TË NDAHEN NËSE AKUZOHEN DHE BETOHEN NDËRMJET VETI

Nëse burrat akuzojnë gratë e tyre për amoralitet, ndërsa nuk kanë dëshmitarë, do të betohen para Allahut katër herë se e flasin të vërtetën ndërsa të pestën herë do të thërrasin për vete mallkimin e

¹⁴¹ Kur'ani: Bekare, 236-237.

Allahut nëse gënjejnë, ndërsa të njëjtën do ta bëjnë edhe gratë dhe pas kësaj mund të ndahen dhe kurrë nuk do të kenë mundësi për martesë.

Allahu i Lartësuar thotë: “Ndërsa ata të cilët shpifin për gra të veta dhe nuk kanë dëshmitarë tjetër përveç vetes dëshmimi i çdonjërit prej tyre është: të betohen katër herë në Allahun se ai e thotë të vërtetë. E pesta (herë e betimit) është: mallkimi i Allahut qoftë mbi të, nëse ai gënjen. E nga ajo (gruaja e shpifur) largohet dënimi, nëse katër herë betohet në Allahun se ai (shpifësi) gënjen. E pesta herë e betimi të jetë që ta godis hidhërimi i Allahut, atë (gruan) nëse ai, ka qenë i vërtetë.”¹⁴²

Buhariu përmend një transmetin të Abdullah ibn Omerit r.a. në të cilën thuhet se Muhamedi s.a.v.s. ka shkukurëzuar bashkëshortët të cilët janë akuzuar mes veti dhe të cilët janë betuar se njëri prej tyre ka bërë kurvëri me ndonjë person tjetër!¹⁴³

NËSE BURRI LARGOHET NGA GRUAJA MË SHUMË SE KATËR MUAJ, ËSHTË I OBLIGUAR QË TË NDAHET PREJ SAJ

Burri mundet të ndahet nga shtrati i bashkëshortes më së shumti katër muaj. Nëse kjo periudhë zgjatë më shumë, atëherë prej saj duhet të ndahet. Allahu xh.sh, tërheq vërejtjen: “Ata që betohen se

¹⁴² *Kur’ani*: Nurë, 6-9

¹⁴³ Buhariu, *Sahib*: 68-Kitabu-t-talak, 34-Babu-t-tefriki bejne-l-mutela’inejni, hadithi nr. 5313.

do të largohen prej grave të tyre (të mos bëjnë kontakt me to), afati i pritjes është katër muaj. Në qoftë se kthehen ata (heqin dorë nga betimi), s'ka dyshim Allahu bën falje dhe mëshiron. E në qoftë se ata kanë vendosur për shkërrorëzim, Allahu dëgjon (fjalët e tyre) dhe di (qëllimet e tyre).¹⁴⁴

Kufiri prej katër muajve është afati përfundimtar që gruaja moralisht të mos devijojë dhe të mos bie në provë duke iu dorëzuar dikujt tjetër e jo burrit të saj. Transmetohet se Omer ibn Hattabi r.a. si halife, një natë është shetitur nëpër rrugët e Medines, duke dashur të dijë a ka nevojtarë për t'u ndihmuar. Në këtë shetitje, vonë në mbrëmje, ka dëgjuar një grua se si këndon:

*U zgjat kjo natë dhe ka ra terri
E unë e shtrirë në krevat, e vetme pa njeri
Pasha Allahun, por të mos ishte ndalesa e Tij,
E cila nuk ka ortaki,
Do të dridheshin anët e krevatit tim...*

Të nesërmen Omeri r.a. e pyeti vajzën e tij Hafsën r.a. se sa mundet gruaja të durojë pa burrë. Ajo i është përgjigjur se afati i fundit është gjashtë ose katër muaj. Prej atëherë, Omeri r.a. askënd në xhihad nuk e ka mbajtur më shumë se katër muaj.¹⁴⁵

¹⁴⁴ *Kur'anî*: Bekare, 226-227

¹⁴⁵ Shih: Sejjid Kutub, vep.cit., 2/213.

NËSE ZHDUKET BURRI, A MUND TË VIJË DERI TE SHKURORËZIMI

Nëse burri zhduket dhe kjo gjendje zgjatë, gruaja ka të drejtë që të shkurojë dhe të martohet për dikë tjetër. Se'id el-Musejeb pohon se gruaja duhet të presë një vit, prej momentit kur burri ka marrë pjesë në luftë dhe është zhdukur.¹⁴⁶

Abdu-r-Rezzaku transmeton nga Davud ibn el Hindi në të cilin thuhet se burri duhet të pritet një vit, nëse është zhdukur në luftë, ndërsa katër vjet nëse është zhdukur në rrethana të paqes.¹⁴⁷

Transmetohet prej Aliut dhe Abdullah ibn Mesudit r.a. se ata konsiderojnë se gruaja duhet të presë burrin e zhdukur deri sa të paraqitet!¹⁴⁸

Nëse pas martesës së gruas paraqitet burri i saj, atëherë çfarë të bëhet? A do të mbetet në martesën e dytë apo do t'i kthehet burrit të parë. Ibn Haxher përmend qëndrimin e Aliut r.a. se do t'i takojë burrit të parë, ndërsa qëndrimi i Esh-Shabiut është se gruaja mund të zgjedhë ndërmjet të parit dhe të dytit.¹⁴⁹

¹⁴⁶ Buhariu, *Sahib*: 68-Kitabu-t-talak, 22-babu hukmi-l-mefkudi fi ehlihi ve malihi.

¹⁴⁷ Shih: Ibn Haxher, *Fet'hu-l-Bari*, 9/339.

¹⁴⁸ Po aty, 9/340-341.

¹⁴⁹ Po aty, 9/341.

NË FUND

Nga gjithë kjo të cilën e parashtruam qartë shihet se islami përdorë të gjitha mekanizmat për pengimin e shkurorëzimit. Shkurorëzimi do të bëhet vetëm në raste të domosdoshme, sepse nga ajo çka ka dhënë Allahu Fisnik, gjëja më e urryer është shkurorëzimi, siç thotë i dërguari Ynë, Muhamedi s.a.v.s. në hadithin e Muadh b. Xhebelit r.a.: *“Nga ajo të cilën Allahu e ka krijuar në faqe të tokës, më e urryer është shkurorëzimi!”*¹⁵⁰

Nga këtu duhet gjetur modus si të ruhet martesë. Është mirë të shfrytëzohet këshilla e sahabiut të njohur Ebu Derdasë r.a. i cili ia tha gruas së vet, duke e këshilluar: *“Nëse sheh se jam nervoz, përpiku të më disponosh dhe qetësosh, ndërsa nëse unë shoh te ti zemërim, do të përpigem të të disponoj dhe qetesoj.”* Imam Zuhri i cili përcjell këtë këshillë të të Ebu Derdasë r.a. thotë: *“Kështu vepronjë vëllezërit e vërtetë!”*¹⁵¹

Nëse respektohet kjo këshillë, shumë martesë do të ishin shpëtuar. Është e natyrshme që burri dhe gruaja ndonjëherë të jenë jo të disponuar, ashtu siç është e natyrshme që pas ditës së bukur me diell, të vijë deri te bubullima e vetëtima dhe reshje, mirëpo për këtë ekzistojnë ombrellat dhe vendet ku njerëzit strehohen. Kështu edhe pas zjarrit të zemërimit të njerit prej bashkëshortëve, duhet përdorur ujën e qetësimit, kështu që në mënyrë të mirë të neutralizohet.

¹⁵⁰ Bejhëkiu, *Sunen*: Babu-l-istithnai fi-t-talaki ve-l-‘itki ve-n-nudhuri, 7/361.

¹⁵¹ Ibn ‘Abdu Rebbih, *El-Tekdu-l-Ferid*, 6/126.

Përndryshe, bashkëshortët duhet të kenë kujdes për veprimet e tyre, kështu që pas realizimit të tyre të mos vijë deri te pendimi. Islami lidhur me këtë për burrin ka sjellë sanksione materiale, ndërsa nëse vepron me aq mendjelehtësi dhe gruan ta shkurorëzojë edhe për së treti herë, atëherë edhe psikologjikisht e dënon në atë mënyrë, siç është cekur më herët, që bashkëshortja të martohet për burrë tjetër dhe të ketë marrëdhënie intime me të.

Mendjelehtësia mund të sjellë deri te ajo që njeriu të bëjë atë që e ka bërë një arab, i cili përnjëherë ka shkurorëzuar pesë gra. Kur për këtë dëgjoji Harun er-Rashidi, halifeja i njohur islam, pyeti në mënyrë të çuditshme: *“Po si ka mundur të ndabet prej pesë grave, kur në bazë të islamit, burri mund të ketë vetëm katër?”* Ka marrë këtë përgjigje: Një ditë ai njeri ka ardhur në shtëpi dhe ka takuar katër gratë e tij se si po fjaloseshin. Pasi që ishte nervoz, iu afrua gruas për të cilën mendoj se ka nxitur fjalosjen dhe i ka thënë: *Ti je e shkurorëzuar!* E dyta ka vërejtur këtë dhe ka thënë: *U ngute me shkurorëzimin. Më mirë do të ishte që të kishe vepruar në mënyrë edukative e jo ashtu!* Burri i tha: *Edhe ti je e shkurorëzuar!* Gruaja e tretë, gjithashtu reagoi, dhe edhe asaj i ka thënë: *Edhe ti je e shkurorëzuar!* As e katërta nuk mundi të qëndrojë e qetë në mendjelehtësinë e tij, dhe i ka folur, ndërsa ai i ka thënë asaj: *Edhe ti gjithashtu je e shkurorëzuar!* Një fqinje krejt këtë e ka parë nga dritarja e saj dhe ka reaguar në shkurorëzimin e tij me të katër gratë për një moment, kështu që edhe asaj i është drejtuar me hidhërim: *Edhe ti je e shkurorëzuar nëse këtë e lejon burri yt!* Burri i saj, i cili gjithashtu ka parë se çfarë ka ndodhë, dhe me siguri mezi se ka pritur shkurorëzimin nga gruaja e tij, ka bërë titur: *Lejoj. Ti je e shkurorëzuar!* Kështu ai njeriu nervoz përnjëherë ka shkurorëzuar pesë gra!¹⁵²

¹⁵² Po aty, 6/124.

Për këtë burri duhet në mënyrë të kthjellët të mendojë në çastin e sjelljes së ndonjë vendimi të tillë. Ai duhet të kërkojë çdo imtësi e cila do t'ia ruajë martesën, e jo të kërkojë detalet e imta të cilat kontribuojnë në shkurorëzim. Në këtë mënyrë duhet të na shërbejë si shembull i mirë rasti i Hasan ibn Ali ibn Hasanit kur ka shkurorëzuar gruan e tij, Ajshe, vajzën e Talhasë. Në momentin e shkurorëzimit, ka thënë: *Gjëja (vendimi) është në dorën tënde.* Në këtë Ajsheja i është përgjigjur: *“Deri më tani vendimi ka qenë dymbëdhjetë vjet në duart e tua dhe në mënyrë të mrekullueshme je përkujdesur dhe je ruajtur. Mos vallë do të më lejosh që unë për një moment të shkatërroj gjithë atë. Jo, unë këtë vendim ta lëshoj ty!”* I çuditur me këtë të kuptuar, përgjigje dhe lidhshmërinë e gruas së tij, Hasani ka hjekë dorë nga shkurorëzimi.¹⁵³

Shpresojmë se këso lloj të shembujve do të ketë më shumë në mesin tonë, të cilat do të kontribuojnë me të madhe në martesën stabile dhe në forcimin e bashkësisë martesore.

¹⁵³ Po aty, 6/125.